

INTERVISTË ME AGIM SYLEJMANIN

Prishtinë | Data: 6 prill, 2022

Kohëzgjatja: 158 minuta

Të pranishëm:

- Agim Sylejmani (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotni Agim, nëse mundeni me u prezantu? Me tregu datën, vendin e lindjes...

Agim Sylejmani: Po.

Anita Susuri: Diçka për prejardhjen e juaj, familjen.

Agim Sylejmani: Quhem Agim Sylejmani, jom me prejardhje nga fshati Përlepticë por i lindur jam në Zhegër, ni fshat afër Gjilanit gjithashtu. Baba ka qenë mësues edhe nëpër teren kur e kanë dërgu kështu të punojë, kështu që rastëisht kom lindë, jom lindë në Zhegër. Në fshat, në Përlepticë kemi jetu pak, gjithsej nja katër vite, plus minus kështu. Pastaj baba ka bredhë nëpër fshatra si mësues kështu që e ka bartë... kah ka shku ka marrë edhe familjen me vete.

Kom pasë babën mësues edhe arsimtar të matematikës. Si familje, nga ana e babës jemi me prejardhje nga pjesët veriore të pushtuara, nga Vraca, ni fshat të shpërngulur në vitin 1978. Nanën e kam nga fshati Makresh i Ulët, ni familje e njohur në trevat e Gjilanit. Pastaj ktu kam ardhë në Prishtinë në moshën shtatë vjeçare, kur edhe kom fillu mësimin. Shkollimin për herë të parë në shkollën tash është, “Naim Frashëri”, më duket, në atë kohë quhej, “Vladimir Nazor”.

Kam ardhë pastaj ktu, pas shkollës fillore ktu këtë gjimnaz kam qenë [Sami Frashëri] {tregon me duar nga dritarja}. Mirëpo, me diplomu për shkaqe, probleme të natyrës politike, me diplomu kom diplomu pastaj në Kamenicë. Gjysëm-vjetorin e dytë të vitit të katërt jam detyru me shku në Kamenicë. Ka qenë ai vit kur edhe m’kanë marrë për herë të parë në pyetje në Sigurimin Shtetëror ktu në Prishtinë.

Pastaj, kam studiu, jom regjistru faktikisht në Fakultetin Ekonomik në Prishtinë, kam mbaru dy vite. Pak para se me i përfundu provimet e vitit të dytë kom qenë i arrestuar me disa shokë në vitin 1979. Më konkretisht 14 janar të ‘79-tës. Ndërsa, në pyetje për herë të parë që e përmenda m’kanë marrë në dhjetor të 1974. Hera e parë kur jom ballafaquar me organet e hetuesisë.

Anita Susuri: Po du, para se me vazhdu te kjo tregimi për burgosjen e për kto, me u kthy pak. Thatë që në moshën shtatë vjeçare keni ardhë në Prishtinë, a ka qenë për shkak të profesionit të babës apo?

Agim Sylejmani: Po edhe profesioni i babës, po ma shumë ka qenë ndikimi i nanës. E cila kur ka marrë vesh që disa po shpërngulen në Prishtinë, jo në Gjilan, por nga fshati në Prishtinë thotë, “Pse shkon ai në Prishtinë kur, a osht’ ma mirë se në Gjilan apo pse?” [Babai thotë,] “Për çashtjen e shkollimit”, “Shkojmë edhe ne pra. Fmitë tanë t’i shkollojmë në Prishtinë”. Ka qenë shkaktari numër ni ka qenë nana që kemi ardhë në Prishtinë, përndryshe ne do të vendoseshim në Gjilan.

Anita Susuri: E qysh ka qenë Prishtina, jeta në Prishtinë çfare ka qenë?

Agim Sylejmani: Po fillimisht ne e dinim si kryeqytet, po kur erdhëm në atë vend, ne pastaj Lagjja Aktash kur kemi ardhë ne ka qenë vetëm ara. Kanë qenë tre-katër shpija gjithsej kështu (qeshë). Kemi qenë pak të zhgënjyer se larg nga vendbanimi i qytetit, por shpejt e kemi, jemi përshtatë në këtë vend. Si fmi nuk kemi mund të dallojmë gjë kështu (buzëqesh). Për ne ka qenë jeta ma...

Anita Susuri: Në cilin vit po i bjen që...

Agim Sylejmani: 1963-tën kemi ardhë në Prishtinë.

Anita Susuri: A ‘63-tën, domethonë ende u konë si ni lloj kasabaje...

Agim Sylejmani: Po, taman kasaba që po i thu ti, taman. Ashtu ni qytezë, ka qenë ni qytet i vogël. Vetëm kjo qendra që ka qenë si qytet me ndërtesa diçka. Aksioni ma i madh ka qenë tre soliterat kur janë ndërtu në Prishtinë (qeshë).

Anita Susuri: E kjo lagjja juj që po thuni, Aktash, a keni qenë, kto ndërtesat po nuk kanë qenë më duket?

Agim Sylejmani: Jo, jo, nuk ka, ato vonë janë ndërtue.

Anita Susuri: Keni qenë duke jetu në shpija apo?

Agim Sylejmani: Në shpi, në shpi kemi qenë gjithmonë, në shpi tonë.

Anita Susuri: Ka qenë e bleme prej juve apo?

Agim Sylejmani: Osht’ ndërtu, se baba e ka ble tokën, vetëm trollin edhe kemi ndërtu shtëpi aty.

Anita Susuri: Thatë që keni vazhdu jetën pastaj në Prishtinë edhe shkollën e mesme keni qenë ktu në “Ivo Lola Ribar”

Agim Sylejmani: Po, përpara osht' qujtë "Ivo Lola Ribar", "Sami Frashëri", "Naim Frashëri", është shkolla fillore atje.

Anita Susuri: Po, "Sami Frashëri". Edhe n'qato vite po thuni që ka pasë probleme...

Agim Sylejmani: Po.

Anita Susuri: A kanë qenë qato vitet kur ju keni fillu me u inkuadru në këto lëvizjet?

Agim Sylejmani: Po, që herët të familjes time nga ana e nanës kanë qenë të ballafaquar me pushtetin. Unë jom rritë, të thuash me edukatën nga ana e nanës se i kom pasë dajhtë gjithmonë nëpër burgje. Që nga '48-ta e këndeje vëllau i madh i nanës, Ramiz Osmani, ka qenë qysh në '49-tën i dënuar me 18 vite burg. Po ndikim ma të madh nga ana e nanës e kom marrë prej mësimit të dajës tim të katërtit, Kadri Osmanaj, Kadri Osmani, më falni se e thashë gabim.

Ai ka qenë gjithsej i dënuar 25 vite. Ka qenë që nga '67-ta kur kanë fillu ta marrin për herë të parë ka mbajhtë burg pastaj përsëri në '69-tën për tentim të organizimit të demonstratave '69-tës i përvjetorit të '68-ës. Pastaj në '74-tën është dënu përsëri nëntë vite, në '84 edhe 15 vite tjera. Domethonë, ka qenë ndikimi ma i madhi nga ana e nanës, thashë. Kështu që, herët kom ra në kontakt edhe me literaturë klandestine që po e qujnë sot, na i thojshim ilegale në atë kohë përmes kësaj lidhje të familjes.

Anita Susuri: E ky daja juj, '46-ën që thatë...

Agim Sylejmani: '48-ën, '49-ën në fakt, '49 më fal.

Anita Susuri: Po. Për çfarë aktiviteti është arrestu?

Agim Sylejmani: Ka qenë anëtar i Organizatës Nacional Demokrate Shqiptare. Kanë bo disa aksione ata. Bile ka qenë ajo... shkaku i arrestimit kanë qenë prerja e shtyllave telefonike Beograd-Prishtinë te vendi i qujtun, Bunari i Përlepnicës quhet ni vend aty. Atë lidhjen nëpërmjet Vrajës - Gjilanit, ato lidhjet telefonike. Pastaj edhe kanë pasë disa atentate ata kanë bërë atje, disa aksione tjera për çka edhe është arrestu në atë kohë si anëtar i Organizatës Nacional Demokrate Shqiptare.

Anita Susuri: E ju si fmi kur keni qenë, a i kujtoni kto biseda, për shembull me nanën, me babën? A kanë qenë të mshefta, a kanë folë hapur me juve?

Agim Sylejmani: Po kështu, ne, unë thashë, kom pasë fat ta kem nanën, se e kom pasë nanën bukur të ngritur edhe pse shkollë nuk ka shku, në shkollë nuk ka shku ajo. Autodidakt me shkru e me lexu, por herët osht', ka kalu nëpër durë të saj edhe literatura e msheft. Te ne, Radio Tirana edhe Radio Kuksi, tërë ditën ka qenë i lëshuar. Kështu që, ato kangtë e kanë bo të vetën. Emisionet e ndryshme

radiofonike që kanë qenë, emisionet dramave të ndryshme që ipeshin në radio ose recitime të ndryshme, kangë, e kanë bo të vetën plus literatura.

Biseda, normalisht pak ma ndaras nga baba, se baba ka qenë gjithmonë me arsimin. Disi e kemi rujtë, ta qujmë ashtu, për mos me humb vendin e punës. Se arsimtartë kanë qenë të rrezikuar në atë çështje por jemi marrë veç kah pjesa e nanës kështu (qeshë).

Anita Susuri: E nana juj si e ka pasë emrin.

Agim Sylejmani: Ilmije, nana quhej Ilmije e lindun Osmani, baba Taib, Taib Sylejmani.

Anita Susuri: E baba juj çfarë, çfarë gjenerate ka qenë? Qysh është arsimu ai?

Agim Sylejmani: ‘34. Ai e ka ni jetë të veçantë. Është i vitit 1934 i lindur, me moshën 16 vjeçare pasi mbaron klasën e shtatë fillon punën si mësues. Hapet ni shkollë në fshatin Muqibabë të Gjilanit, në malësi atje. Por merreni me mend tash ni djalë i ri 16 vjeçar, pa i bo 17, shkon atje edhe jeton në mal (qeshë), në ato kushte. Ajo ka qenë ni plejadë e mësimeve që ne mund t’i imagjinojmë se mjerisht sot nuk ka aso përkushtimi... asi përkushtimi nuk ka ma qysh ka pasë përpara, mësimeve.

Po pastaj ka vazhdu shkollimin e tij edhe ka punu edhe ka vazhdu shkollimin. Ka arritë me mbaru [Shkollën] Normalen ktu në Prishtinë, pastaj ka mbaru edhe Shkollën e Lartë Pedagogjike për matematikë në Prizren. Osht’ marrë edhe me inovacione, ka qenë inovator. Ka disa inovacione të tija matematikore. Është marrë edhe me studime të ndryshme të shkencës matematikore ku i ka tri punime të rëndësishme nga lëmia e matematikës, algjebër edhe gjeometri. Ka punu në arsim 40 vite dhe u penzionu pastaj.

Anita Susuri: E ktu në Prishtinë, në cilën shkollë ka punu?

Agim Sylejmani: Ai ka punu në disa shkolla në fakt. Fillimisht kur kena ardhë ktu, ai u konë në fshatin Miradi, Dobrevë i thojshin ma herët, në atë kohë kur jemi ardhë ne. Pastaj ka punu në shkollën fillore, “Aca Maroviq” atje në Fushë Kosovë. Ka punu pastaj në, “Emin Durak”, pak pastaj në, “Miladin Popoviq”, pastaj, jo, janë ndrru, ndryshe quhet, “Miladin Popoviç”, ka qenë ajo shkolla e mesme, jo aty jo. Pastaj ka punu qat’, “Vladimir Nazor”, të njejtën shkollë ku unë kom mbaru shkollën fillore edhe aty osht’ penzionu pastaj.

Anita Susuri: E që po thuni për literaturën në kohën kur nana e juj i ka pasë, a e dini qysh kanë mbri ato deri në Kosovë?

Agim Sylejmani: Po. Familja Osmani kanë qenë të gjithë të përfshirë në rrjedha të organizimit klandestin. Dy vllazër të Kadriut, dy dajë tjerë, më i vogli dhe ky para Kadriut kanë punu si punëtorë sezonal në Austri. Ata, mbaj mend unë si fmi, kur sillnin literaturë me thasë edhe i shpraznin në dhomë aty. Edhe pastaj prej atyhit shpërndaheshin gjithandej. Kjo lidhje na ka mundësu neve që të kemi nëpër durë literaturë të ndryshme, romane të ndryshme, libra sidomos të Enver Hoxhës. Ne i kemi pasë nëpër dorë gjithmonë ato. Kështu që jom, kom ardhë në kontakt qysh herët.

Pastaj, para se të arrestohem '78 është, na pat' lindë si ide ne si shoqni, si shokë ishim, si studentë nëpërmjet, Jugosllavenska Knjigës [Srb: *Jugoslovenska Knjiga* - Libri Jugosllav] kemi bërë parapagesën për gazeta të ndryshme të Shqipnisë. Nifarë mënyre ktu në Prishtinë e kena pasë komplet shtypin ditor, javor e mujor atje në Shqipni që ka dalë, komplet e kena pasë në Prishtinë nëpërmes "Jugosllavenska Knjigës" në Beograd.

Anita Susuri: A ka pasë mundësi me u bo kjo?

Agim Sylejmani: Po, abonim, parapagesë...

Anita Susuri: Prej Shqipnisë me ardhë ktu?

Agim Sylejmani: Edhe na vinte, nëpërmjet Beogradit na vinte shtypi nëpërmjet Beogradit. E dinim që ato na kontrollohen, po secili... unë i kom pasë marrë "Zërin e Popullit" edhe "Nëntorin", ni revistë letrare. Dikush e merrte, "Shqipëria e Re", dikush "Bashkimi", dikush "Yllin", e kështu me radhë. Edhe, "Sportin Popullor", bile e kemi pasë si gazetë me përdorë në atë kohë.

Anita Susuri: Mu po më intereson tash, do të kthehem prapë te literatura po, se jemi n'qato vitet '60-a, kur ka qenë edhe periudha e Rankoviqit. Qysh, a e keni vretjtë ju ndonjë lëvizje apo presion ose a u vretjtë kjo brenda qytetit? Largimi i njerëzve? Familjet që kanë shku?

Agim Sylejmani: Unë tash në atë kohë, kohën e Rankoviqit '66-ten kom qenë fmi, kështu që nuk mund shumë të them që e kam ndje personalisht. E kemi pasë atë që gjithmonë kem të bojmë me ni pushtet, jemi të pushtuar gjithmonë. Se thashë, Radio Tirana, Radio Kuksi te ne kanë qenë rregullisht, kemi pasë radio qysh herët edhe në fshat atje baba ka pasë radio. E nana ime gjithmonë e ka pasë, veç në kanalin e Tiranës ose të Kuksit, ato dy vendet ajo ka lujtë me radio. Kështu që, në ato gjërat, ato i prananim, vinin ato deri te ne po si fmi ndoshta nuk e kemi pasë atë idenë si...

Po nana ime ka qenë e ballafaquar qysh si vajzë e re kështu me policinë gjithmonë, se gjithmonë ju ka shku në shpi. Gjithherë bile kur kanë ardhë nga Beogradi kta pushtetarët e mdhej shumëkush të familjes të nanës i kanë marrë i kanë fut brenda [në burg] deri të kalon ajo vizitë. Se saherë ka qenë [në vizitë] Titoja, ni pjesë njerëzve të familjes të nanës veç i kanë izolu për qat' kohë, në atë kuptim. Kështu që, nana ime ka qenë e pregatitur për atë punë. Ajo i strehojke.

Bile e mbaj mend, këtë e mbaj mend librin “Tradhëtija”, prej të parëve, prej gjithë tjerëve nana e ka pasë lexu. E pshtillte me gazeta në mill. E kena pasë ni si bure për mill (qeshë), e fuste aty ajo. Po tinza babës, baba nuk dinte. Domethonë, ruheshte. E kemi rujtë babën mos me impliku kto që edhe me marrë në pyetje diçka mos me qenë në gjendje me tregu asgjë, në atë kuptim.

Anita Susuri: Prej shkollës të mesme ju keni hi në këtë lëvizjen apo fillimisht vet keni pasë naj aktivitet? Qysh ka ndodhë krejt kjo?

Agim Sylejmani: Fillimisht ktu në gjimnaz ka qenë ni brez, ai brezi, tash secili brez është i mirë mos të keqkuptohemi. Por unë them kam qenë me fat që i kam taku atij brezi, kur në Kosovë edhe në të gjitha viset shqiptare në ish-Jugosllavinë ka pasë, është bërë ni rizgjim kombëtar, ku të rinjtë shumë shpejt kyçeshin nëpër rrjedhat politike klandestine. Edhe nëse nuk ishin të kyçun dikund, krijonin rrethe të vogla shokësh, e bojshin ni rreth, fillojshin ata veprojshin nifarë mënyre. Kërkonin literaturë, sidomos kërkohej me këmbëngulësi literatura e fshehtë. Sikur ni i uritur që kërkon bukë se ka nevojë me hangër.

Kom ra [në kontakt] herët me literaturën që tregova, por sidomos në vitin e parë edhe të dytë në gjimnaz, kanë qenë ato vitet vendimtare të përcaktimit të jetës time. Pastaj, në ‘70 e... unë thashë që ‘69-ën veç pata qenë në burg që e mbajsha mend që kam qenë ma i rritur se ‘67-ën ma pak mund të them po për ‘69-ën veç isha i rritun, isha 13 vjeçar, isha në gjendje me kuptu shumë gjëra. Mbaj mend burgosjen edhe dënimin e dajës që ka ndiku shumë tek unë.

Pastaj me disa shokë ktu në gjimnaz, se ktu në gjimnazin kanë qenë si të thush gjithë fëmijtë e parisë së vendit, ne qysh në atë kohë, borgjezia e vendit. Por kishte mjaft prej fshatrave me të cilët na... unë ktu jam rritë, po fshat... nuk muj me thanë që jam prishtinali se rranjtë i kam nga fshati. Edhe ma lehtë gjindesha në shoqni me këta që vinin nga fshati. Kështu që, kemi pasë ni rreth të shokëve ktu në gjimnaz edhe ktu ka fillu ajo. Pastaj në ‘74-tën faktikisht më kanë pasë marrë për herë të parë edhe në hetuesi. Ka ni javë ditë kom shku, çdo ditë më kanë marrë në pyetje.

Anita Susuri: Ju kanë nxanë me literaturë?

Agim Sylejmani: Jo, kanë qenë që, po e shpjegoj shkurt, po përpiqem. Ka qenë... dajën e kisha në burg, në atë kohë i patën burgosë disa nga krerët e Grupit Revolucionar të Kosovës, ku Kadriu ka qenë drejtues i atij grupi. Ni trakt i ktij grupit, ni fjali përkonte me ni fjali të ni letre anonime që ia dërgojnë ni profesorit tonë, e kemi pasë ni profesor të gjuhës shqipe. Në të njejtën kohë, kjo, gjithë kjo kohë që po flas, kemi pasë edhe ni hartim, “Rinia edhe kontributi i saj në shoqëri”. Unë edhe duke menduar që jam te profesorat [dhe kemi qëndrime të njëjta] kom shkru në atë mënyrën time, duke përmend me Adem Demaç, Fazli Grajçevc e të gjitha edhe kontributi i tyre në shoqni. T’u mendu që qashtu osht’, profesorit, nuk kena mendu që profesori shkon në Sigurim atje i dorëzon ato hartimet.

Kështu që, ni fjali e hartimit tim koincidojke me pasë të ngjashme me ni fjali të traktit, por edhe në fjalinë e letrës anonime që merr profesori. Kto të gjitha pastaj lidheshin, se pas hartimit unë kom pasë tani, unë kom pasë tani... ai ka qenë i ngarkuar profesori që me folë me nxanës që kto të arritura që i kemi nga Jugosllavia, nga Titoja. Ai thojke ashtu, unë thojsha, “Nuk është e vërtetë”, u kthejsa nga nxansat, “Po rren profesori se kto janë marrë me mundim e gjak”. Domethonë, ai ballafaqimi me profesorin në klasë. Nji vajzë që ka qenë e organizuar ajo, Sabrie Grajçevci, ka qenë e organizuar me Hidajete Osmanin, vajzën e Kadri Osmanit. Ato kanë qenë grupi i vajzave ma të reja të anëtarëve të Grupit Revolucionar. Shumë pak flitet për to...

Anita Susuri: A janë ato ende gjallë?

Agim Sylejmani: Po, gjallë janë. Sabile Keçmezi ka shkruar për këtë Hidajetën. Kanë qenë pra ni grup i ktyne vajzave. Kjo vajza pastaj i kallxon shoqeve të veta në celulë, ato pastaj e shtijnë vllaun e Hidajetës, njo ma i vogël me shkru që mos me pasë shkrimin e njejtë. Ia dërgojnë profesorit letrën anonime. Ni fjali ishte fjalia që unë e kom përdorë edhe në debat me profesorin edhe në hartim edhe në trakt koincidonte. Kjo ishte tani shkak për me më marrë edhe në hetime. Mirëpo, isha i mitur, akoma pa e mbushë moshën madhore, kështu që më lanë të lirë në atë kohë.

Anita Susuri: E qysh e keni pritë ju qat’ ballafaqimin me sistemin atëherë? A ka pasë ndonjë frikë a e keni ditë?

Agim Sylejmani: Jo frikë, e kisha ni urrejtje, ni urrejtje. Urrejtje që vështirë është me shpjegu ndoshta. E kisha dajën brenda, ma kishin marrë dajën për herën e tretë në burg. Ndjejsa atë urrejtje dhe ballafaqim. Ma së vështiri më vinte se ata më flisnin shqip, ishin shqiptarë ata që më merrnin edhe isha i ri. Mirëpo e kisha përkrahjen, thojsha, të nanës. Nanën e kom pasë ma shumë se nanë e kisha edhe shoqe timen ku, edukatën në fakt e kam marrë nga nana, mund ta quj ashtu. E kom pasë vështirë në atë kohë, se rashë në pozitë të tillë që e dija që do t’ma humbnin vitin. U duhtë pastaj me gjetë ni zgjidhje. Kta donin me mbajtë në gjimnaz për me ma humb vitin në fakt. U detyrova me shku me ni vend tjetër, në këtë rast në Kamenicë. Pata shku aty atëherë, aty kom mbaru gjimnazin pastaj...

Anita Susuri: Keni fillu me udhëtu?

Agim Sylejmani: Jo, kam, kam banu atje me ni banesë private me ni shok. Se edhe ni shok e patën përjashtu, qat’ shokun që jam dënu ma vonë edhe atë e kanë përjashtu. Se kanë qenë edhe disa aksione, janë bo do bojkotime të mësimi n’atë kohë e për disa nxanës kshtu. Të gjitha kanë qenë të lidhura. ‘74-ta ka qenë shumë intenzive. ‘74-tën pikërisht në dhjetor u pat’ bo aksioni i madh i shpërndarjes së trakteve edhe shkrimit të parullave në Qendër të Studentëve, nëpër Prishtinë gjithandej. Ka qenë, ta qujë, rrëmujë kështu të veprimtarisë kundrejt pushtetit që pushteti nuk dinte

ku t'ia ngjet. Njerëzit i kishte brenda, i kishte pesë veta mrena në burg, po puna knej vazhdonte. Mandej edhe m'kanë marrë. Në këtë kohë m'kanë marrë mu, përkon me këtë situatë.

Anita Susuri: E në... çfarë pyetje ju kanë bo, për shembull në ato bisedat informative?

Agim Sylejmani: Jo, nuk ka qenë bisedë informative, unë thashë hetime. Drejtpërdrejtë më kanë marrë në pyetje hetuesia. Ata kërkonin të dhana me ditë sa po nxjerrin për Kadri Osmanin, për dajën tim, për Xhafer Shatrin, sa, a e kom taku naj here, a e kom pa. Binakun e kta, Binak Ulën e kta. Unë i pata taku të gjithë në fakt. Por një më herët si na pat' mësu edhe nana, por edhe ai daja i ka thanë nanës, [i ka tregu] se si duhet të sillemi ne në rast arrestimi. Në qoftëse pyesin a e ke pa filnin, a filanin, "Po dikund i kom pa." "Çka kanë bo?" "Kanë qenë t'u mësu për studime". Në këtë kuptim ose, "Kanë lujtë shah". Por, jo biseda që me mbajtë mend biseda çka kanë dëgju tjetër. Kështu që, kam qenë pak i përgatitun se si të sillem te ata. Kisha Xhevdet Shushkën, landën time që e ka pasë që m'ka marrë në pyetje n'atë kohë edhe më kanë liru pastaj pas ni jave.

Anita Susuri: A ka pasë ndonji, ku e di, kërcënim ose diçka?

Agim Sylejmani: Po, po kërcënim ktu edhe pa rrahje nuk m'kanë lshu, po nuk më kanë torturu, nuk mund të them që më kanë torturu në atë kohë. Po m'kanë rrah, por jo turturë. Kërcënime...

Anita Susuri: Ka pasë edhe rrahje?

Agim Sylejmani: Po, rrahje ka pasë por jo shumë, se i kom përjetimet tjera që ato nuk i llogarisë në atë kuptim (qeshë).

Anita Susuri: Po edhe kjo dhunë është.

Agim Sylejmani: Po dhunë po edhe kam qenë i ri sigurisht. Ata janë përpjekë ma tepër me më kriju frikë. Kërcënime me frikë e me... edhe me lajka sigurisht. Edhe lajkat fillimisht kanë qenë. Se ata fillojnë me lajka, të bojnë për vete, premtime të japin e këto të gjitha që si i ri mund të bijsh shumë lehtë në të.

Anita Susuri: E po më intereson gjatë shkollës së mesme, a e keni ditë për shembull kto biseda me kond me i bo? Prej kujt me u rujtë?

Agim Sylejmani: Po, po, po, ato të gjitha i kemi pasë. Tash saktësisht ku qysh ndoshta nuk e di me të tregu me saktësi kur na kanë thanë, por qysh si fmi, a din, që me pasë kujdes me kënd flasim edhe, "Për Radio Tiranën e Kuksin që i dëgjojmë rregullisht nuk duhet me ju tregu tjerëve çka dëgjojmë në shpi". Rujtjen e fshehtësive na kanë mësu si fmi, gjithmonë m'u rujtë. Jemi ardhë me ni qytet... në fillim kur më the ti [i drejtohet intervistuesës] që qysh jemi përjetu ato fillimin, kemi pasë këto

udhëzimet e nanës, me pasë kujdes me kënd flasim edhe çka flasim. Këto, nga frika se gjithmonë kanë qenë, familja e nanës kanë qenë të survijum edhe ka mbetë, ju ka mbetë ajo.

Edhe kur kemi ardhë në Prishtinë e ka pasë atë kujdesin. Ndoshta edhe ajo e ka bo të vetën që, që ka ndiku që unë t'jom edhe i kujdesshëm. Se unë thashë ktu kanë qenë të gjithë fmitë e pushtetarëve. Ka pasë që kanë punu në Sigurim të shtetit, ka pasë kanë qenë në pushtet lokal e qendror. Në klasë i kom pasë gati, ktyne të pushtetarëve. Aty me dy-tre vet kemi komunikuar kështu për gjana të ndryshme. Me qit' Sabrijen ka qenë ajo me gjithë motrën e vet aty. Veç përkatësia e asaj familje ka ndiku që të jemi të afërta me ato vajza, besim, çashtje besimi.

Anita Susuri: Po a kanë kontakt, për shembull me juve ato që kanë qenë të organizume, që e kanë vrejtë ndoshta...

Agim Sylejmani: Po, po kom qenë në kontakt. Po, po kom qenë në kontakt me këtë Hidajetin që thashë, se vajzë të dajës e kom. Kemi qenë ni klasë bashkë edhe pse ishte ma e re ajo ka qenë ni vit ma herët në shkollë. Kështu që, vitin e parë kemi qenë bile në gjimnaz ktu bashkë me ni klasë. Kemi pasë kontaktet me ato, se literaturën tash kemi marrë e kemi dhanë njani-tjetrit. Ne kemi nda literaturë njani-tjetrit, por pa tregu se ku e mora. E kemi pasë kështu që as nuk kemi pytë prej kujt e ke marrë. Kemi pasë, kemi qenë të mësuar në atë kuptim që nuk duhet me pytë. Sa ma pak me ditë ma mirë, se e pëson ma keq me ditë ma shumë. Kështu na kanë mësua.

Anita Susuri: Po, po. E masi keni kalu në shkollë edhe kur e keni ndrru, a ka vazhdu edhe atje... kur keni fillu me qenë i organizum?

Agim Sylejmani: Kjo osht' pikërisht periudha kur filloj të punoj në mënyrë të organizume me shokë. Krijojmë celulat e para pa qenë të lidhur me ni organizatë. Kemi vazhdu në Kamenicë edhe me disa djem tjerë të Kamenicës atje. Bashkë me ni shok timin kemi banu bashkë, Faik Latifi, i fshatit Hajkobillë, me të cilin jom dënu tani bashkë. Edhe vllau i tij ka qenë. Atje kemi, jemi përpjekë me shpërnda literaturë çka na binte në dorë neve me dërgu edhe në Kamenicë.

Pastaj, atje edhe kemi hasë në ni grup të vajzave që kanë qenë të organizume. Vajza të gjitha 15-16 vjeçare që kanë formu ni grup. Kishin shitë ata dikund, ni familje ni vajzë të re. Kanë çu te burri me 15 vjeçare, prej shkolle e kanë nda e kanë... thuhej se e kanë shitë familja se kanë qenë e varfur e kanë dhanë për lekë, për pare. Kto vajzat pastaj në revoltë e sipër, e formojnë ni organizatë, "Kenzara". Secila nga një shkronjë të secilës vajzë edhe formojnë fjalën, "Kenzara". Edhe për me, luftë për të drejtat e grave në këtë kuptim e kanë pasë.

E shkrujnë ni trakt e shpërndajnë traktin e shkrujnë parulla nëpër qytet atje derisa i zbulojnë. Ne jemi lidhë me këto vajzat pastaj. Ndoshta edhe ka qenë kjo ni arsye ma shumë që të lidhemi edhe me gruan

time, se në atë kohë jom njoftë me të. Domethonë, na ka lidhë ky orientimi. Ato pastaj e kanë llogaritë ato vajza që u lidhëm me dikë në Prishtinë (qeshë), në atë kuptim se ne ishim aktivë qysh thashë...

Anita Susuri: E bonëm ni kontakt.

Agim Sylejmani: Po, kontakti, se ashtu e llogaritshin ato. Ne pastaj ndoshta, mos ta qujë shfrytëzim, por kemi shfrytëzu rastin që jemi njoftë me ato vajza ma tepër. Kështu që, unë jom feju edhe jom martu pastaj me këtë Zymrijen, ndërsa ai shoki im Faiku me vajzën e tezës të saj, Mihanën. Të dyja kanë qenë të organizume në këtë grupin që e kanë drejtu. Nëpërmjet tyre pastaj jemi lidhë me disa djem tjerë të ri aty. Kemi pasë, kemi pasë kriju pastaj me Faikun ni grup të rive. Shumë entuziastë!

Do filma kur i shohim ose romane të kohës të Luftës së Dytë Botërore na kësi soji m'duket kemi hasë në këta të ritë. Sikur [filmi] "Debatiku" në Shqipëri gjatë Luftës, ne i kemi has qita të ritë që po flas në Kamenicë. Kështu që, nifarë mënyre i kemi marrë kta në organizim të gatshëm, domethonë veç me i orientu si po punohet se kta veç janë të kyçun. Bile grupi m'duket e ka pasë emrin, "Para Agimit", ose, "Bashkë me Agimin", qishtu diçka ka qenë grupi i tyre. Kanë pasë ata të caktum personin përgjegjës edhe kështu.

Edhe pse të ri, unë thashë, 15-16 vjeçar, 17 vjeçar po kanë pasë grup të vetin. Kur jemi arrestu pastaj në '79-ën të gjithë kanë marrë gati... se qaq shumë impulsiv kanë qenë që dilnin, flisnin, shpërndanin dhe bërtinin në atë kohë që akoma ishte e paimagjinueshme me dalë në mënyrë publike m'u ekspozu. Po nuk mujke njeriu me i ndalë ata, kanë qenë shumë djem të mirë ata edhe vajza, mos te harroj.

Anita Susuri: Kjo organizata juj cila ka qenë ma saktësisht edhe çfarë aktivitete ju keni bo?

Agim Sylejmani: Ne si celulë pastaj jemi lidhë me këtë grupin e të rive në Kamenicë, me OMLK-në nëpërmjet Jashar Alijaj. Jashar Alijaj ka dalur nga burgu '78-ën në korrik, e ka dashtë fati që të lidhem me të se ka qenë i dënuar bashkë me dajën tim Kadriun. Edhe çashtje besimi edhe ne i kemi hyjnizu, ta qujsh ashtu, i kemi hyjnizu të gjithë të burgosurit politikë. Kështu që, na dukej si diçka mbinatyrshëm.

Kështu që edhe i kemi respektu shumë, kemi qenë shumë të dëgjushëm ndaj tyre, çka t'na kishin thanë kishim bo, qaq besim të madh kemi pasë. Kështu që, kom pasë atë fat të lidhem me të. Nëpërmjet meje ka qenë pastaj gjithë ky grup, jemi lidhë apo jemi bo pjesë e OMLK-së, Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës. Domethonë, kta nuk kanë pasë shumë punë me neve se na kanë gjetë të gatshëm.

Në rrethin tonë ka pasë të Preshevës, të Kërçovës, të Tetovës, Strugës, Kamenicë, Gjilan, Prishtinë. Kemi qenë ni rreth bukur i gjanë. Kur na kanë arrestu neve nja 50-60 vetë janë marrë. Përveç në hetuesi në pyetje, po ka pasë kah ni muj e ka dy muj kanë majt shumë prej ktyne të rive. Fati ka qenë që kta kanë qenë të mitur të gjithë, nën [moshën] 18 vite. M'u dënu pastaj jom dënu veç unë pesë vjet.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Cilat aktivitete kanë qenë që keni bo edhe qysh ka qenë plani? A ka pasë plan apo ndonjë organizim për me i bo këto?

Agim Sylejmani: Shiqo, detyra parësore ka qenë ngritja ideo-politike, leximi i literaturës, shpërndarja e literaturës. Një trakt që u shpërndajke, atë trakt ne e shumëzonim dhe e shpërndanim ma tutje, se merrnim disa ekzemplarë edhe e kishim ma lehtë. Përndryshe, shpesh i përshkrunim edhe me dorë me i shpërnda, se i jepnim tjetrit vazhdonte me shkru me dorë me ia dhanë tjetrit me përshkru në mungesë të teknikës. Në aktivitete të ndryshme kur organizohen nga pushteti, m'u fut aty me kqyrë me fut ndikimin tonë tek të ritë, te masa e të rive. Kryesisht te të ritë nuk... nifarë lloj hezitimi kemi pasë me moshës ma të madhe, domethonë kemi majtë [kontakt] vetëm moshatarët ma të ri se ne.

Organizimi pastaj kur jemi lidhë me OMLK-në ka qenë pastaj shumë rigoroz. Konspiracioni u dashke pastaj me u frenu në atë kuptimin që nuk mund të ekspozoheshim qysh jemi ekspozu deri në atë kohë. Disa lidhje u dashke me i ndërpre sa për sy e faqe para të tjerëve, që jemi prishë ose kemi ndërpre kontaktet për mos me ra në sy. Takimet i mbajshim msheft me shokë, u dashke me u taku msheftas që mos me ra në sy që po vazhdojmë shoqëri në atë kuptim.

Anita Susuri: Çfarë vendi për shembull?

Agim Sylejmani: Po, shumë takime takime i kemi majtë edhe jashtë në natyrë i majshim, po edhe nëpër banesa. Këta shoktë që ishin me banesa private, nëpër banesa të tyne. Në konvikte te shoktë merrnim dhomat e shokëve kur kishim takime, që kishim simpatizantë ose anëtarë të grupit që ishin në dhomat e tyre ku banonin në konvikte, na lironin ato dhoma. Po kryesisht i kena majt në natyrë, ato ma të mdhajat në natyrë i kena majtë.

Anita Susuri: E...

Agim Sylejmani: Në Taukbashçe, në Gërmi, nëpër mal kryesisht natën. Po kemi funksionu shumë ma mirë se sot. As nuk kena pasë orë dore, as nuk kena pasë celular, as internet, po me funksionu kena funksionu. Takimet, ni sekuencë ndoshta është me rëndësi me ditë, nëse kemi pasë ni takim, të hanën ta them kushtimisht në 8:00 në mramje kemi shku ma shumë se pesë minuta nuk jemi sjellë në atë pjesë aty. Se osht' dashtë me ecë mos me ra në sy të dikujt, çka po kërkon ky njeri këtu. Pas ni jave prapë u dashtë me shku deri të mirret kontakti me atë person, domethonë osht' përsëritë ose në javtë ose në dy javtë i njejt vend e njejt orë. Ka qenë, kanë qenë shumë intenzive këto (qeshë).

Anita Susuri: E për literaturën, po m'duket ka qenë edhe ni linjë që ka shku prej Shqipnisë diku në Evropë jashtë tani prej Evropës ka ardhë në Kosovë, qysh u bo ky transport?

Agim Sylejmani: Kta që kanë vepru ktu kanë bo çmos të krijojnë lidhje të veta me punëtorër që hyjnë e dalin. Unë thashë që kom pasë qat' fat me i pa dajtë e mi kur vinin nga Austria me thasë. Ata i merrnin, të gjitha ato i merrnin në Ambasadën e Shqipërisë në Vienë. Atje shkonin i merrnin me thasë. Transporti ka qenë shumë i rrezikshëm në fakt se shumëkënd e kanë zanë. Ni libër me ta nuanë të Enver Hoxhës të futnin në burg. Kta sillnin me thasë, domethonë kanë qenë të vendosur në atë kuptim edhe me vetëdije e kanë bo punën.

Sikur kta dajtë e mi kanë punu edhe tjetër. Shembull, osht' ni Shurdhani ni fshat afër Gjilanit, Hasip Avdullahu, gjithë djemtë e tij kanë qenë nëpër burgje edhe në mërgim. Ai si punëtor, ai sa herë ka ardhë, sa herë e kanë thirrë fmitë, "Na sillë këtë, na sillë këtë. Shko merri filan veni këto libra". I ka marrë, i ka sjellë, me dhjetra libra ka sjellë ktu në Kosovë. Punëtorë të tillë ka pasë, se pa mbështetjen e ktyne nuk kishim mujtë me bo asgjë. Literatura ka pasë atë ndikimin, numër një, në orientimin ideo-politik tonin. Se ne prej atyhit kena mësu se na mungon diçka ose çka duhet të punojmë. Prej asaj literature, se nuk ka pasë kush na mëson.

Anita Susuri: E qysh e keni ditë ju, për shembull kujt me ia dhonë qat' literaturë ose a keni identifikuar naj person ose grup që keni besim?

Agim Sylejmani: Kështu, ta marrë ni shembull, ni shok timin që kisha të fminisë edhe të shkollës, është nga fshati Gradicë ai, i Drenicës. Për me ia dhanë vetëm ni libër, "Shota dhe Azem Galica", ni vit të tërë kam bisedu kohë pas kohe për kso tema, por pa i tregu që jam i organizum. Edhe e kisha shok të ngushtë edhe akoma e kam shok të ngushtë, po jo me i tregu që jom i organizum, në asnji mënyrë. Edhe librin si libër mas ni viti e fitoj guximin me ia dhonë librin në dorë.

Traktin, ni trakt që është shpërnda në '78-ën me rastin e njëqind vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kam thanë, "More ni letër ma ka fut dikush në xhep në fakultet, çka mundet me qenë kjo? A mundet me qenë e UDB-së, a çka mundet me qenë?" Për me ia dhanë me lexu atij, jo për tjetër. Pastaj, me i thanë atij e kom zhdukë se krijova dyshimin që dikush me qëllim ma ka bërë. Për mu ishte mjaft që ai me lexu shkrimin, atë traktin. E llogaritsha që kom bo ni punë, e kom shpërnda. Ksi soji kemi funksionu.

Anita Susuri: E këto trakte, çfarë përmbajtje kanë pasë për shembull?

Agim Sylejmani: Përmbajtje, ta qujmë kushtimisht për zgjimin tonë kombëtarë. Të dijmë ma së pari kush jemi, çka na mungon, çfarë e drejte mungon, çfarë të drejta duhen të kërkohen. Jo vetëm çështje sociale po edhe çështje kombëtare, çdo gjë ka qenë. Edhe pse është e mveshun me çështje ideologjike, por thelbi ka qenë për çështje kombëtare çdo gjë. Bashkimi me Shqipërinë, çlirimi dhe bashkimi i ktyne shqiptarëve me Shqipërinë, kaq.

Anita Susuri: A e keni përcjellë ju ndoshta edhe suksesin e qityne aktiviteteve?

Agim Sylejmani: Po, po.

Anita Susuri: Për shembull sa? Nuk e di, a keni mujtë me ditë sa persona kanë ra në kontakt me qito traktin, me qito libra?

Agim Sylejmani: Shiqo, ne, si shembull, dhe kur u shkrujke ni parullë dikund, dikush gjithmonë e ka rujtë nga larg me kqyrë a p'ë fshinë para se me e pa njerëzit. Shembull p'ë marr, veç ni shembull p'ë marr, shkruhet ni parullë 130 metra e gjatë në asfalt Hogosht-Kamenicë rrugën edhe ni shok, ai del 100-200 metra plus minus me pushkë e ka rujtë ata që kush te prekë me gjujtë me pushkë me trem. Po le të vijne autobusi le ta sheh. Vjen autobusi i parë, e shohin të gjithë, e shohin, dalin e shohin shkrimin edhe vazhdon autobusi edhe ky shkon në shpi, si shembull.

Pastaj, te traktet gjithmonë, gjoja se, “Çka ken qito letra? Kush, çka po gjujnë? A UDB-a p'i qet, a mos po provokojnë diçka”, për m'i nxitë njerëzit çka po thojnë për ato letra. Edhe nëse nuk kish ndëgju ai. Se kryesisht i futnin nër dyrë, u hedhnim në oborre, kështu. Ka pasë trakte që edhe i kena ngjitë, po kryesisht nër dyrë edhe mbi dyrë.

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë periudhë të caktume të ditës kur i keni bo këto shpërndarje ose këto aktivitete?

Agim Sylejmani: Këto u bojshin zakonisht natën, gjithmonë natën janë bo këto. Pas orës 12:00.

Anita Susuri: Keni pasë për shembull 15 minuta ose disa minuta...

Agim Sylejmani: Jo, koha ka qenë e caktuar, nga ora kaq në orën kaq. Fiks. Edhe nëse nuk ke arritë m'i marrë ato duhesh m'i kthy te mrapa, se ma gjatë jo. Ka qenë çdo gja e planifikume. Ata që kanë drejtu, kanë qenë shumë të ngritur, jashtëzakonisht. Ma vonë tani dikë e kom njoftë kështu [personalisht], po nuk e kom ditë që osht' në organizatë tonë, aq ma tepër që osht' dikush si kokë e jona. Se pas ramjes [në burg] së Kadri Osmanit, Xhafer Shatrit, Binak Ulaj, e Jashar Alijaj ka vazhdu Hydajet Hyseni me Mehmet Hajrizin kta. Kta çdo gja e kanë, në imtësira i kanë planifiku gjërat domethonë.

Kur është antarësu dikush kta e kanë tëhollu çdogja për personin a bon, a s'bon ai person. Domethonë, janë fut në hollësira që ne nuk kishim mujtë të imagjinojmë. Po kërkesa qysh ka qenë e shokëve, na jepshin ato mësimet ku edhe si mos me shkelë, në atë kuptim mos me shkelë në drrasë të kalbtë. Se ka pasë shumë shpijunazhë, ne kta duhet ta pranojmë.

Anita Susuri: A ka ndodhë, për shembull që keni kuptu ndonjë shpijunazh të dikujt ose që dikush sigurisht ka ra në burg për shkak të shpijunazhit. A i keni ditë këto?

Agim Sylejmani: Po. Po te ne nuk ka pasë të paktën deri në atë kohë kur kom ra në burg unë, nuk ka pasë dekonspirime nga brenda, nuk ka pasë denoncime nga brenda që dikush nga anëtarët, në atë kuptim me u thy e me tregu. Me na përcjellë, e me na shpijuni ka pasë sa të dushë. Në lagjën ku jom rritë unë te menza e studentëve, mes menzës edhe sallës së sporteve, ni rrugë aty, ne faktikisht unë bile prandaj edhe kom dalë nga aty. Se vend ma të mirë, ma të shtrejtë s'ka, por unë kom thanë aty nuk jetoj se s'jom ndje kurrë mirë, se të gjithë ata kanë qenë nifarë mënyre të përzimë me pushtetin. Kështu që, nuk, nuk jom ndje mirë. Gjithmonë e kemi ndje atë përcjelljen edhe survijimin e fqinjëve. Kanë qenë të porositun ata, regjimi e ka bo atë punë.

Anita Susuri: E po më intereson me ditë për kohën kur, në fakt jo për kohën, po këtë organizimin në celula, po më duket kanë qenë treshe?

Agim Sylejmani: Treshe, po. Dyshe dhe treshe. Se ka edhe shumë që nuk ka shku te treshi, kanë mbetë vetëm dy, ka vazhdu tjetri. Secili ka kriju dyshet e treshet e veta, po me treshe, sistemi i treshit është.

Anita Susuri: Juve ju ka kontakti dikush për me formu me juve celulën apo?

Agim Sylejmani: Unë thashë fillimisht jemi organizu vet.

Anita Susuri: Vet, po tani...

Agim Sylejmani: Me këto mësimet e literaturës, këtë sistemin e treshës e kemi mësu nga literatura. Se sistemi i treshit është përvojë e Partisë Komuniste të Shqipërisë gjatë Luftës Nacional Çlirimtare. Ata kanë fillu me këtë sistemin e treshit. Kështu që, ne këtë sistemin e treshit e kemi lexu edhe nga literatura si funksionon tamam, tani jemi, kemi mësu masi jemi kyç në organizim të organizatës. Ne kemi vepru si treshe po për me marrë me mësu tamam sistemin e treshës e kemi mësu pasi jemi fut në OMLK.

Anita Susuri: A keni pasë edhe vende ku keni kopju këto? Thatë që keni shkru edhe vet...

Agim Sylejmani: Po.

Anita Susuri: Po a ka pasë edhe dikush që ka bo kopje për me shpërnda?

Agim Sylejmani: Thashë, kopje ma pak kena pasë mundësi. Ka qenë shumë e rrezikshme me i marrë me i çu me i shumëzu. Fotokopjues nuk ka pasë në atë kohë. Shaptilograf apo geshitetner që i thojnë ato ka qenë ma problem për me i marrë. I bojshim planet na për me i rrëmby kështu, kishim planet tona në vende ku hashim që ka edhe bënim planet ne si të ri, akoma pa ra. Me OMLK-në na

planifikonim me siguru teknikën, por pastaj me kontaktin me OMLK-në ne faktikisht nuk kishim nevojë se OMLK-ja e kishte teknikën e shumëzimit. Kishim pastaj edhe mjaft material të shtypur, hazër, nuk kishim nevojë, materiali i gatshëm ishte nuk kishte nevojë me shumëzë.

Në këtë periudhë lidhet edhe koha e '78-ës është interesant, pak vetë e përmendin. '78-ën janë prishë definitivisht marrëdhëniet Shqipëri-Kinë. Kështu që, në këtë kohë t'u dëgju nga Radio Tirana edhe nga Radio Kuksi që dërgonin letra të ndryshme, mbështetje Partisë së Punës edhe Enver Hoxhës, edhe këtu kemi shkru letra të tilla. Shumë letra i kemi dërgu, me disa shokë i dërgonim në Bullgari në Sofie i dërgonim drejt në ambasadë. Po kishte që i dërgonim edhe nga posta. Natyrisht u përpiqim me ata tonën me i zhdukë gjurmët e me do letra për me i lshu në kutia të postës drejtpërdrejtë.

I dërgonim ose në ambasadë në Beograd prej këtu ose i dërgonim nëpër ambasada tjera, po kemi dërgu letra të tilla. Ka qenë kjo e '78-ës vit i veçantë se ka qenë viti, përvjetori, njëqind vjetori i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit kur nga Shqipëria pastaj vijne edhe me ekspozita të ndryshme, me simpoziumi që osht' organizu këtu. Ai ka qenë vit shumë shumë i gjallë. Kështu që shumë lehtë binin në kontakt me të rinjtë, me njani-tjetrin me ide të njejtë.

Anita Susuri: Përveç organizimit që keni pasë edhe për shkak, po mendoj, situatës të vështirë politike që ka qenë prej '74-tës për shembull, po u konë edhe ni send i mirë që u bo kushtetuta në atë vit. A u vërejtë ndonjë dallim diçka ose qysh ka ndiku te ju kjo?

Agim Sylejmani: Ta qujë liberalizimi {bën me duar thonjëzat}, jeta shoqërore e vitit '74, pikërisht ajo e shkaktonte atë vështirësinë se u dashke me punu shumë tepër për me bindë tjetrin që kjo nuk është ajo çka po kujtojmë. Kështu që, ne e kemi pasë të vështirë se dikush e ka ndi vetën që tash ma lirshëm, ma i lirshëm edhe universiteti u pat hapë. Ka qenë vështirë... prandaj, unë të thashë, ni vit m'u ka dashtë për me fitu atë besimin që edhe shokut tim me ia dhanë ni libër.

Ne megjithatë jemi përpjekë edhe mes rreshtave, se "Rilindja" ka qenë autoparlant i regjimit të Beogradit, nuk ka qenë që diçka e jona edhe për neve. Ata e kemi pasë autoparlant të regjimit. Po përpiqeshim mes rreshtave të kuptojmë diçka, por orientuese e kishim Radio Tiranën edhe Radio Kuksin. Në këto situata shumë herë na. Pas '74-tës kemi debatu mes veti me shoqërinë, kështu kur mblidheshim të ritë që mblidheshim jo vetëm si shokë të organizum por me të tjerët, kishim ato përplasjet e çështjes të jetës së përditshme se kemi një avancë të startuesit të autonomisë, po kjo nuk është ajo çka na duhet, se ne megjithatë jemi të pushtuar.

Ne kemi bo përpjekjen tonë që njerëzit ta kuptojnë që ne jemi të pushtuar. Se brezi i baballarëve tanë kanë qenë ta qujë edhe kushtimisht edhe të frikësuar nga pushteti. Se kanë, përjetimet e tyre kanë qenë për neve ndoshta të pa imagjinueshme në atë kohë çka kanë përjetu ata pas Luftës së Dytë Botërore. Pastaj, shpërngulja masive për në Turqi e ka bo të vetën, i ka frikësu njerëzit edhe brezi i baballarëve tanë pak a shumë kanë qenë të frikësuar. Neve pastaj na u deshke me e bo punën e

dyfishtë. Sidomos në vetëdijësimin e masave edhe njerëzve për ato që i kishim edhe çka na takojnë edhe ato që na mungojnë.

Pastaj pse po u dashka me qenë ni shtet e na mos me qenë me shtetin tonë, pse na të jem me dikë tjetër, ne nuk jemi të njejtë. Pastaj patëm ra edhe në kontakt me materiale që ishte Konferenca e Bujanit, qysh n'atë kohë na e patëm pasë në dorë. Pse atëherë ka qenë garantuese edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe Bashkimi Sovjetik që pasë luftës të vendosim ne vet për jetën tonë. Domethonë, kto kanë qenë, patën fillu në këtë kohë kanë qenë debate të vazhdueshme në mes të rinjëve.

Anita Susuri: E a keni pasë edhe aktivitete përveç shpërndarjes së trakteve, librave për shembull edhe shkrimin e parullave ose, a keni bo ju ktë?

Agim Sylejmani: Unë para burgut jom marrë ma tepër me traktet edhe me literaturën. Domethonë, si detyrë parësore e kom pasë shpërndarjen e literaturës. Sigurimin edhe shpërndarjen e literaturës edhe materialet interne të organizatës si të interpretohen te të tjerët, si të kuptohen ato. Domethonë, ngritjen e rrjetit të të rinjëve, jom marrë me të rinjtë ma shumë se e kom pasë qat' detyrë edhe nga shoktë që të merrem me qat' grupin e të rinjëve, që thashë të Kamenicës. I kemi qujtë në Kamenicë se aty ka pasë edhe nga Gjilani po kanë qenë kështu të gjithë të moshës së re.

Anita Susuri: E në OMLK a keni pasë ju nofka, për shembull, e di që në ilegale i kanë pasë për mos me e ditë emrin e sakt?

Agim Sylejmani: (Qeshë) Po unë kom pasë qaq shumë saqë kaniherë edhe i ngatërroj nuk i di të gjitha. Po prej të parës e kom pasë Skender Arifi edhe nuk e di pse e kom marrë këtë emër. Skender e kom hasë edhe në literaturë kështu, në romane të ndryshme po e kom marrë si. Para arrestimit e kom pasë këtë pseudonim. Gjatë burgut pastaj e kom marrë ni pseudonim të cilin e kom mbajtë edhe pas burgut, Tomor Shpata, po njëkohësisht kom pasë Gramozi, kom pasë Afrimi, Ilazi. Kto bile mas burgut, nëpër rrjete të organizatave, ma së shumti m'ka njoftë rrethi jonë organizativ si Ilaz, Ilazi.

U dashke me ndrru domethonë vazhdimisht. Në terene të ndryshme, në celula të ndryshme me pseudonime tjera, se kështu ka funksionu treshi. Mos me u njoftë ni person me ni pseudonim, i njejtë edhe diku tjetër, po nejse ka funksionu. Unë nuk e di, nuk e imagjinoj sot si kemi funksionu n'atë kohë, as shënime s'kemi guxu me majtë, asgjë, por kemi funksionu.

Anita Susuri: Po kjo osht' bo me qëllim që nëse bjen dikush në burg mos me ditë emrin e sakt?

Agim Sylejmani: Mos me ditë, po, po. Po kem shokë që kanë hangër dajak ia kanë përmend ni pseudonim që në atë rreth s'e kam pasë unë as nuk e ka ditë kush osht' ai person. Shpesh bile na ndodhë me këtë zëvendës ministrin e mbrojtjes, Shemsi Sylën, edhe ate e kanë pytë për Ilazin, ai s'e ka

ditë kush është Ilazi (qeshë). Se në atë teren s'kam qenë Ilaz, e kom pasë ni pseudonim tjetër, tjetër emër edhe shumë mirë që s'e ka ditë edhe u ndërpre aty edhe janë detyru pastaj me lshu. Mas shtatë-tetë muje e kanë lshu Shemsi Sylën, se nuk kanë gjetë kërkund. Se ai ma së pari s'e ka ditë për kënd është fjala. Ka shumë raste të tilla.

Anita Susuri: E tash po më intereson edhe...diku thatë që edhe brenda burgut keni pasë pseudonime...

Agim Sylejmani: Po.

Anita Susuri: Pse ka ndodhë, për shembull brenda burgut?

Agim Sylejmani: Unë kom pasë fatin, që tjetër nuk e kanë pasë nëpër burgje. Kom qenë i ri, ma i riu prej atyne të burgosurve që kanë, që kam hasë në burg. Me Rexhep Malajn që është vra me 12 janar '84-tën, ka qenë Skender Kastrati, nga organizatorët e demonstratave të '68-ës, unë kam qenë ma i riu. Se me 21 vjeç kam ra në burg, më kanë majt para dursh ata, në atë kuptim. Thom kom pasë fat, çka edhe burgun e kam shndërru në ni shkollë taman të vërtetë të revulucionit, qysh e qujë.

Aty tani e kom mësu ABC-në e komplet organizimit si bëhet, se kemi pasë edhe literaturën pastaj. Gjë që dikujt po i the që kemi pasë literaturë të ndaluar në Prishtinë, unë e kom pasë në burg, krijohet imagjinata si ka mundësi? Po jap veç si shembull, "Materializmi dialektik dhe historik", libri kopertinat i ka pasë nga Tirana, libri, por kopertinat i ka pasë të "Rilindjes", Ilija Kosanoviq "Materializmi dialektik" i Ilija Kosanoviq. Edhe normal ata në burg as që e kanë imagjinu që po na vjen ni libër tjetër. Ose, "Mic Sokoli", librin e kanë lyp njerëzit me qiri knej me lexu, unë e kom pasë në burg atje si roman por me kopertina tjera. Unë thashë, çdo gja ka qenë lidhje e dytë. Se, "Mërgatën e Qyqeve", edhe ata.

Kur i kom dërgu nga burgu te shpija, shoqja desh u çmend nga gëzimi çfarë libra, "Unë po i kërkoj gjithandej s'pi kam, më erdhen nga burgu". E kemi pasë kriju na ni rrjet të tillë, se niherë kemi shkru, kemi nxjerrë nga burgu po edhe na ka ardhë lidhja mrena në burg gjithmonë. Kemi pasë shkëmbim me jashtë. Këtë e kom pasë fat me Rexhepin edhe Skenderin. Sidomos këto i ka bërë Rexhepi, ka pasë lidhje shumë të fuqishme, ka pasë lidhje të vazhdueshme me jashtë. Edhe ka qenë ajo përparësi që kam qenë edhe unë në rrjedha, me të bashkë kam qenë edhe unë në rrjedha me çka po ndodhë ktu mrena në Kosovë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë lidhur me ditën kur jeni arrestu, qysh ka ndodhë? Qysh ka qenë paraprakisht domethonë çka ka ndodhë edhe qajo ditë?

Agim Sylejmani: Kështu, siç ju thashë, kisha punë me atë grupin e të rinjëve të Kamenicës se kanë qenë shumë impulsivë që ishte e vështirë me i frenu. Ishin të vetëdijshëm që ata shumë shpejt mund të bijnë në burg edhe ashtu edhe ndodhi në fakt, se ata kishin shumë aktivitet. Edhe literaturën, që

thashë unë, gazetat edhe revistat e Shqipnisë ua dërgonim edhe atyre po ata i shpërndanin jashta asaj çka u deshke me i shpërnda. Domethonë, jashta rrethit të ngushtë ata i shpërndanin edhe ma tutje. Kështu që, ranë shumë shpejt në sy të Sigurimit.

Arrestohen filimisht ata të ritë në Kamenicë, po arrestohet edhe kjo Mihanja që e përmenda, vajza e tezës së grusë time. Mirëpo, kur shkojnë me arrestu ajo u qëllu te i fejuari në atë kohë në Hajkubillë, se është i Hajkubillës ai shoku. Në fakt, atë Vit të Ri të '79-ës e kemi pritë bashkë në Prishtinë. Fillimisht me atë që përmenda, Jashar Aliaj, e kemi pritë na tre çifte shokë. Te tretë ishim me... ato te trijat ishin shoqe edhe shoqja ime me vajzën e tezës, por edhe ni shoqe tjetër të organizume që e përmenda shoqërinë, "Kenzara", grup i vajzave të reja. Kemi pritë në atë formën ilegale Vitin e Ri, shokë të ilegales. Për mu është ni kujtim shumë mbresëlënës.

Pastaj natën e vitit të ri e kemi pritë te unë ne dy shokë, ai me të fejuaren unë me gruan time. Edhe kanë vazhdu ata rrugën për në Hajkubillë ku kanë vazhdu pastaj për pushim të vitit të ri. Në këtë kohë e kërkojnë këtë vajzën. Ata nuk kanë ditë çka me i thanë, "Te i fejuari duhet të jetë se s'osht' në shpi", edhe shkojnë e marrin Mihanën. Mirëpo, kur shkojnë atje bojnë kontrollë edhe e gjejnë një poezi, "Grushta atdheu, grushta gjaku, grushta revolucionit", të Agim Gjakovës por me dorë e shkruar. Se unë thashë ma herët, i përshkruanim me dorë ne, kur nuk kishim shumëzues në atë kohë. Atij i kishte ngelë me ni fletore. Bile e përshkruar disa herë me ngjyra të ndryshme të lapsit, qysh ka qëllu se osht' e gjatë ajo poezia.

Kur e shohin atë, e marrin edhe këtë shokun. Kanë gjetë edhe letra tjera. Në mesin e tjerash kanë gjetë edhe disa letra nga ushtria që kanë komunikë vllau i tij Tefiku me ni shok të celulës që e kisha, Abedin Hyseni, tash është i ndjerë. '84-tën ni aksident i ka ndodhë te Ivangradi, atje ka vdekë nga aksidenti. Zihen letrat e vllaut të tij, por pastaj shohin që letrat nuk qenkan të Faikut, por qenkan të Tefikut. Shkojnë e marrin edhe Tefikun. Në këtë kohë unë veç e pata marrë vesh se erdhën kta të ritë, shumë agjil kanë qenë. Meniherë i kanë njoftu të gjithë që janë arrestu.

Unë s'kam dashtë me dalë në ilegalitet. Lidhja ime që thashë, Jashar Aliaj, më pat' thanë se i kanë thanë kta shoktë. Bile konkretisht i kish pasë thanë [Hydajet Hyseni](#) thotë, "Nëse ka nevojë..." ai bile i fshatit tim por ka qenë në ilegalitet Hydajeti. Osht' koha kur ai është detyru me Kadri Zekën me dalë në ilegalitet. Kanë qenë në ilegalitet të thellë, "... që nëse ka nevojë me të nxjerrë me të strehu dikund ose me të nxjerrë jashtë". Unë s'kom pranë se thojsha m'u kanë burgosë shoktë do të shkojë edhe unë qatje ku janë edhe ata. Domethonë i vetëdijshëm isha që do të torturohem. Isha i vetëdijshëm për çdo gjë në fakt. Kam qenë i përgatitun, kur m'kanë arrestu unë kom qenë i përgatitun në atë kuptim. Kanë ardhë m'kanë marrë niherë. Ka ardhë Faik Nura, ni UDB-ash me ni tjetër. Dy kanë qenë herën e parë, ditën e parë. Kanë ardhë veç me më marrë kështu në pyetje...

Anita Susuri: Në shpi te ju?

Agim Sylejmani: Po, te ne. Edhe më kanë liru të nesërmen se s'kanë gjetë shumë... se unë e kisha ni aparat të fotografive në këtë kohë. Fotografonim gjëra të ndryshme po edhe nga këto gazetat që po i përmendi unë edhe revista fotografonim fotografi të Enver Hoxhës edhe i shumëzoni pastaj fotografitë, i shpërndanim kështu. E një prej tyre ma gjetën kështu rasisht edhe pse jam kujdesë të mos me më ngelë najnjë. Se kisha kohë, e kom pastru shtëpinë n'atë kohë lidhur me materialet mos me m'i gjetë.

Nejse, edhe pse i kisha nga “*Jugoslovenska Knjiga*”, këta m'i morën ato, “Zërat e Popullit”, dhe, “Nëntorin” m'i morën nja 200 e diçka ekzemplarë m'i kanë marrë. Të nesërmen më kanë liru se unë s'kam pranë asgjë edhe domethonë mbeta i pafajshëm ta quj ashtu, “S'di asgjë po gazetën e kom marrë”, si asgjë domethonë, sikur punë loje. Shkojnë pastaj me marrë ni shok të Abedinit, se e marrin Abedinin për shkak të ktyne letrave që thashë në ushtri. Prej ushtrisë që kanë shkëmby me shokun e vet.

Shkojnë me marrë si dëshmitarë, me pytë si informacion ni shok të Abedinit edhe ai ish në celulë. Kom qenë në celulë me kta te dytë. Sot, ky Hasani, Hasan Bektoshi është mjek atje në Kërçovë. Kur shkojnë te ai me marrë, “Anatomia” ka qenë në tavolinë edhe kta gjithmonë ia kanë bo fletave kështu, t'u i shfletu, i kanë shkund pak librat. Bjen aty ni trakt i përshkruar me dorë. Kta kanë mendu që e kanë zanë atë origjinalin e traktit, kush e ka ideu, kush e ka shkru traktin edhe e kapin menjëherë. Kështu që, pastaj mu kanë ardhë përsëri m'kanë marrë se m'kanë gjetë si duket edhe shenja të gishtave kanë gjetë diku, po s'ka rëndësi ajo.

Definitivisht pastaj më marin me 14 janar '79-tës, ktu në burg të Prishtinës. Dhe kam qëndru vet deri në gjykim edhe pas gjykimit deri në nëntor të '79-tës kur më kanë dërgu për gjykim në Prizren. Edhe atje kam qenë vet derisa u bonën ato arrestimet e vjeshtës të '79-tës kur i burgosën shumë vet, pas vizitës së Titos. Nja dy javë më kanë fut' me ni dhomë ku ka pasë të burgosur të tjerë edhe pastaj nuk kishin vende si duket mjaft, u dashke me na shprazë nga burgjet e Kosovës. Na kanë dërgu pastaj në Zenicë.

Anita Susuri: Fillimisht kur ju kanë marrë domethonë ju keni qenë në burgun e Prishtinës...

Agim Sylejmani: Në burgun e Prishtinës, tanë kohën në Prishtinë.

Anita Susuri: E qysh ka qenë qajo ditë? E di që në fillim po duket që kanë qenë torturat ma...

Agim Sylejmani: Ne nga ato që kishim mësu përpara, zakonisht bohen lajka, të lusin, të ofrojnë, të premtjnë. Edhe e dija që nja dy-tri ditë kta do të më lusin po pse a krisin meniherë natën e parë nuk e kom bo mend (qeshë). E kom pritë, por bash kaq shpejt nuk e kom pritë. Unë e kisha fatin thashë që kisha ni nanë të përgatitun edhe kur m'kanë përcjellë, ti thush, edhe pse durë lidhur m'kanë përcjellë janë dalë jashtë me më përshëndet me grusht edhe gruja edhe nana. Natyrisht ndihesha i fortë se e

kisha ni përkrahje, nuk isha vet në atë kuptim. Grujën e kisha të organizume me mu, bashkë ishim na. Deri në korrik kanë zgjatë hetimet, po hetimet me tortura kanë zgjatë deri në fillim të qershorit...

Anita Susuri: Sa muj po i bjen?

Agim Sylejmani: Po nja katër muj, pesë kështu. Të dielen e kishim pushim. Si duket sikur ata të krishterët që kanë dielën pushim kështu (qeshë). Po kemi pasë, në fillim kanë qenë dy herë në ditë, gjatë ditës edhe në mramje kah ora 8:30, 7:30, 9:00. Sidomos, atëherë ma herët në janar, shkurt është ma herët, errësohet na merrnin edhe ma herët. Edhe kur na kthenin nganjëherë në ora 1:00-2:00, atje në qeli. Nganjëherë na ngrëshin zhag as nuk e dishim ku jem kështu. Por kom pasë fat që kam qenë vet.

Tash kom pasë fat se kanë, ni burg, në Prishtinë siç ka qenë burgu nuk është ky që është bo pastaj. Ka qenë, kushtet kanë qenë të tmerrshme. Kanë qenë kah shtatë a tetë ni vend. Tash llogarite këtë vend {shpjegon me duar hapësirën dhomës} kaq, shtatë-tetë vet me qenë këtu. Sikur peshqit në sardinë. Tamam sikur peshqit në ni konzervë të sardinës. Unë kom qenë vet. E kom pasë atë përparësinë që s'paku ajrin e kom pasë të pastërt. Të pastërt kushtimisht.

Anita Susuri: A ju kanë lanë në vetmi apo?

Agim Sylejmani: Në vetmi vet tash gjatë tërë kohës kam qenë, po jam ndje ma mirë. Me rend shtëpiak kishim të drejtë nja dy libra në dy javë. Mirëpo, neve nuk na lejojshin ashtu. Mirëpo i përgatitun në atë kuptim, që thashë, kom bo ni grevë urie tre ditë. Ditën e katërt m'i kanë leju. Ata kishin interes që unë me hangër se mos me hangër tani nuk mujshin me m'rraf me më torturu atje (qeshë). Kështu që, u detyrun me m'i dhanë. Edhe unë, kështu që, pas tri javësh unë e kom pasë të drejtë m'i marrë librat, po në emër të asaj që unë du me vazhdu m'i përgatitë provimet.

Fillimisht me literaturë të fakultetit po edhe nga ni libër romane e kështu tjera. Mirëpo, kam qenë vet edhe nja ni muj nuk kom pasë fare shëtitje, domethonë tërë kohën brenda. Vizitën e kom pasë të parën pas, më duket pesë javë, plus minus mos të gënjej me data. Edhe po ka dy herë fillimisht, njëni po m'pytë tha, "A ju rrahshin?" Thashë, "Po, na kanë dhanë desert. Po ata aty për qat' punë na kanë marrë" (qeshë). Qëllimi kryesor pastaj ka qenë, se e dinin që jemi në kontakt me Jasharin, po nuk dinin sa është i thellë kontakti. Edhe Jasharin e kanë marrë në maj, nantë ditë e kanë majtë.

Mirëpo, ne jemi, e kemi mbrojtë edhe unë edhe ky shoku Faiku, e kemi mbrojtë, nuk e kemi dhanë. Çdo gja, çka ka qenë që bijke ndesh me ata që kishte rrezik që t'merret e merrshim përmi vete ne. Kështu që, Jasharin e kemi kursy në atë kohë edhe ka shpëtu. Deri në '81-shën kur u burgosë në fund të '81-shës pastaj edhe aty e kanë arrestu. Na jena dënu pesë vetë. Kur thashë nja 40-50 a 60 vetë sigurisht janë marrë edhe në pyetje, po edhe janë dënu nga një muj e dy muj kështu burg, si të Strugës,

të Kërçovës, të Tetovës, të Gjilanit, të Kamenicës, sidomos ata të ritë, të gjithë. Kanë qenë të mitur i kanë majtë kah një muj ato vajzat në burg.

Asnjë dorë, ktu du me cekë se shpesh bijmë ndesh me disa edhe sot e kësaj dite, unë nuk jom në gjendje me i kuptu disa. Asnji shka¹ nuk m'ka ra as shuplakë, se lëre më me ndonjë mjet tjetër. Të gjithë kanë qenë shqiptarë, po them ma mirë shqipfolës. Se kur thojnë, po e kanë pasë për detyrë, në ligj nuk ka shkru. Thonte ai, një, Zoran ia mbaj mend atij [emrin] UDB-ashit, thojke, “Me ligj nuk kam të drejtë me të prekë, unë të vetmen që muj [është] me të lonë me të majtë në kamë, mos me t’lanë me u ulë, kta kam të drejtë me ba. Por me të rreh nuk kam të drejtë, se me ligj nuk na lejohet. Mirëpo, ata të juvt, ata nuk e di. Kta, aty maju mirë. Ndash fol te unë pa rrahje, ndash shko andej”.

Krejt e kuptueshme për mu që i kanë lujtë rolet kështu, po kur ka qenë puna për me zbatu torturat i kanë zbatu shqiptartë. Kështu që, neve kryesisht edhe vetëm shqiptartë na kanë torturu në burgun e Prishtinës. Pa përjashtim. Kanë qenë disa xhahila, Asllan Sllamniku, ka qenë Muharrem Dana, Faik Nura, Lorenc, Lorenc, Lorenc i Klinës në moment ia harrova mbiemrin. Pastaj ka qenë Ajet Istogu, pastaj ka qenë Bashkim Kursani. Kta, tash me ia shpjegu dikujt se çka na kanë bo në burg mundet me thanë e ke pa ni film me gestapo, se veç gestapoja ka bo qashtu. Ne kemi pasë rastin t’i njohim drejtpërdrejt, t’i përjetojmë në kurriz tonin.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Unë kom ndëgju edhe do, tash me thanë, rrahje të shpejta edhe të ngadalshme. Diçka kanë qenë si dy lloje diçka të torturave.

Agim Sylejmani: Jo, qikjo e shpejta ka qenë ma e mira. Kjo ka qenë ma e mira...

Anita Susuri: Mrapa...

Agim Sylejmani: Shumë shpejt shkon puna, kom pasë raste të tilla edhe unë. Kom pa që ka qenë ma mirë qasi soji, me i sha ose me reagu disi që me të mshu ma shumë edhe me të alivanosë. Niherë e kom sha njënin edhe e di që më kanë alivanosë për dy minuta. Unë ma nuk kom ditë hiç, veç kur e kom pa vetën t’u më tërheqë zhagas deri te qelia. Ata i kanë pasë torturat e ngadalshme. Janë ato që i kanë [pasë] ato si torturë i kanë të ngadalshme që derisa të rraskapisin që mos me qenë në gjendje, të dërmojnë, mos me qenë në gjendje me ecë në kamë tua ose mos me mujtë me kap as batanijen me durë tua, as mos të ushqehesh me kamë tua. I kanë pasë ato.

Ata e kanë pasë atë kujdesin bile mos me të lanë shenja. Edhe pse ato krytë u bojke sa ni boston i rrumbullakët kështu. Për mos me thanë pastaj nëpër trup gjithë qivit që thojnë kështu, zi, trupi

¹ *Shka* (m.), *shkinë* (f.), shumë *shkijet*, term derogativ që shqiptarët e përdorin për serbët.

boheshte prej të ramve. Mirëpo, e kanë pasë edhe të ngadalshmen ajo ka qenë ma, ma e preferuara e tyre. Mjet i tyre i preferuar.

Anita Susuri: E qysh ka fillu, shembull nashta fillon me naj pyetje ose, qysh...

Agim Sylejmani: Unë thashë, unë prej se ato lajkat e premtimet që i kanë zakonisht që i patëm mësu na në bazë të literaturës se i kam qitu...

Anita Susuri: Po mendoj, a ka pasë ndonjë reagim?

Agim Sylejmani: I kom sjellë edhe juve me ju tregu një, “Armiku na ka në dorë aq sa lejojmë na vet”, aty janë disa udhëzime se si duhet të sillemi ne. Për shembull, as mos me marrë kafe prej policit aty, as mos me marrë cigare, m’i ikë kësaj konfidencës me të, me pasë distancë, mos me marrë asgjë prej tyre domethonë. E kem armik, në atë kuptim edhe mos me leju me ra në atë pozitë bisedës...

Anita Susuri: Po, me kriju najfarë mardhanje.

Agim Sylejmani: Hiç, absolutisht hiç edhe... mirëpo mu më kanë ra pa më pytë fare hiç. S’më pytën as kurgjo hiç, më ranë përmenerë kështu. Ishte ajo e para më kanë llogaritë ta frikësojmë, e kanë përdorë mënyrën e frikës fillimisht, pastaj lajkat, ato tjerat. Se thashë, u gjetë ai trakti i shkruar me dorë edhe lidhja pastaj se si shkonte krejt shkonte si natyrshëm që vinte te unë. Meqë ishte zanë trakti dojsha me marrë përsipër unë, se mujsha me refuzu edhe mos me pranu, po dojsha për me u shkëputë aty mos me shku ma tutje. Thashë, “Po, traktin në xhep ma ka fut dikush në fakultet”. Kaq.

E kom majtë këtë qëndrim gjatë tërë kohës. Se aty është e keqja në qoftëse me dajak pranon diçka, del diçka me dajak atëherë e pat’ vetën në qafë. Ata tani ta shtrojnë dajakun deri... edhe çka s’ka dojnë me nxjerrë nga ti. Kështu që isha i vetëdijshëm për atë punë. Nejse m’kanë torturu, por nuk, nuk jom pendu pse e kom duru atë torturë. Kom qenë shumë, ni ndjenjë që e kom vështirë me e përshkru, jo veç krenari, po osht’ ni ndjenjë edhe gëzim i brendshëm është që ktu u kputë nuk shkoi ma tutje. Le të dënojnë sa të dënojnë.

Anita Susuri: Po, kjo osht’ ma e keqja domethonë nuk keni arritë...

Agim Sylejmani: Prej neve nuk dulë askush, domethonë organizata nuk u prek. Jashari u morë nëntë ditë, po me kaq edhe ai ka vazhdu Jashari ma tutje. Domethonë, vetëm ni degë e tyre ra nëpër durë të UDB-së, tjerat meti pa prekë. Për neve ajo kishte rëndësi.

Anita Susuri: E a ka pasë gjatë këtyre seancave të torturës naj dialog a diçka që kanë kërku? Sigurisht kanë kërku emra të njerzëve?

Agim Sylejmani: Po, po, emra, ato vazhdimisht. Ajo ka qenë e vazhdueshme, prezente. Ata shembull e kanë pasë kaliografia, si quhet kjo për shkrime, ka pasë ekspertë të tillë që e ka kopju shkrimin tënd për merak. Për shembull, ma sollën niherë që përmenda qit' niherë që ne veç planifikonim me marrë ni shaptilograf me ni shkollë në Dabishefvc atje, se e kishin pasë bo skicën ata shoktë krejt. E kishin bo vendin ku me marrë e ku, të gjitha ka qenë e përgatitun në fakt. Por na, arrestimi jonë, ajo ka ngelë, a u realizu përndryshe.

Tash ma sjellin letrën që, “Ja shoku yt çka ka deklaruar që keni deshtë me marrë”, ajo kish rrjedhë dikund. Prej ktyne të rive ka mujtë, kta që kanë bo kto skicat, e dishim kush i ka bo, unë e dija kush i ka bo. “Qe”, tha, “shoku yt. Qe lexoje çka po shkrunë”. Mirëpo veç ni fjalë e kishin gabu, “Geshtetner”², në vend se shaptilograf. E thashë, “Bukur e pasni shkru. Shkrimin ia pasni kopju mirë”, thashë, “po ai nuk e di çka osht' geshtetneri. Ai veç shaptilograf e din çka osht'. Geshtetner kurrë këtë fjalë s'e ka ni veç ktu e ka msu te ju”. E u nervozun, e i grisnin aty për aty.

Domethonë, edhe këto i kanë përdorë kta. Njëpërmjet deklaratave të tjera gjoja të nënshkruara e krejt. Tamam shkrimi i atij shokut tim edhe nënshkrimi i njeiti, s'mujsha me thanë që s'osht' e tij. Mirëpo, ni fjalë që m'ka bo që nuk e ka thanë ai edhe kam qenë ma i lirë. Po kto ata emra kanë lypë normalisht që me gjetë vegzen.

Anita Susuri: A ka pasë për shembull kërcënime për familjen?

Agim Sylejmani: Po, po, po. Ato, kërcënimet. Ma s'shumti, ma së keqi e kanë pasë kta që kanë qenë të martuar, i kërcënojnë, jo kena me ta nda grujen, kena me ta marrë grujen, kto kanë qenë, shumë të randa kanë qenë kto. Kto edhe nuk fliten me gojë kështu. Gjitha kto i kishim parasysht, mirëpo janë të randa. Ata që i përjetojnë bukur të randa këto. Se aty mundohen, aty m'i kap, aty m'i thy moralin...

Anita Susuri: Po, thymja psikologjike.

Agim Sylejmani: Thymjen e moralit të ni burgosurit aty e thyejnë. Se unë kom pasë rast, për shembull, në burg të Foçit po e tregoj veç ni rast, po kcej pak degresion po boj. Mas dy vizitave erdh ni i burgosurit politik, ni kroatit gruja në vizitë. Edhe kur dulë ai ishte i humbur fare, as nuk dike ku osht'. Edhe na çka ka ndodhë? Mos i ka vdekë dikush, mendja jonë, se ishim msu me kta tontë. Tha, “Gruja ma tregoj ni fotografi”, tha, “sa të jesh ti në burg”, më tha, “qiky”, tha, “të zëvendëson”. Domethonë, te ata thyheshin moralisht për tokë. Vet ia kurdisshin... UDB-a këtë punë e ka bo, i ka thy moralisht ma s'pari të burgost për me i përvetësu për qëllime të veta. Kështu që, kanë qenë të randa kto.

Unë thashë e kisha mbështetjen e nanës edhe grusë shumë të fortë, kështu që nuk e kisha shumë problem. Nana ime ka ndodhë që ka shku osht' përta me ata nëpër zyre. Për shembull, këtij shokut një herë ia pata dhanë librin, “Sheshi i Unazës”, e pata nda në dy pjesë, shumë e trashë për me fut ktu ndër

² *Gestetner*, firmë gjermane e maqinave të shtypit dhe shumëzimit të materialeve.

rryp. Edhe kur e kom kthy, e kom kthy dy copsh e grisur. Edhe nana ka mendu që e kanë grisë UDB-ashët. Pikërisht te ky Faik Nura që e përmenda, te ky ka shku në zyre edhe veç sa s'u kacafytë me të, "Pse me grisë librin e djalit?" Thotë, "Jo, na nuk e kena grisë. Pytne djalin se s'e kom grisë".

Mirëpo, ajo, e kisha atë mbështetje domethonë. Kisha ni mbështetje që m'jipshin kurajo, m'jipshin forcë vet familja domethonë, se ka shumë randsi. Se moralin e të burgosurve që kanë qenë të martuar, në fakt moralin ia kanë majtë gratë te shpija. Mund me u mashtru dikush që unë kom qëndru, po t'kish ndodhë gruja me lëvizë sikur që e përmenda rastin e kroatit, nuk kishin me qenë aq të fortë në burg që kanë ndejtë me kushte të tmerrshme kanë ndejtë disa.

Anita Susuri: A keni pasë edhe vizita kur kanë fillu me ju leju, për shembull?

Agim Sylejmani: Po, po vizita jo kështu po ni rrjet ndërmjet me kto rrjet shumë, që nuk shiheshte mirë po ma tepër imagjinative edhe larg a larg prej rrjetit u deshke nja ni metër, dy. Faktikisht, me shku ti vet me pa dikë, meniherë të ikë ai oreksi me pa edhe niherë atë person ashtu. Se osht' ni ndjenjë shumë e keqe. I ke dy anash [policë] ktu ata familjartë i kanë dy anash tjetër. Veç kqyrin kush çka po thotë, kush çfarë shenje po bon, osht' e randë. Edhe aty, dy minuta, tre minuta hiç ma shumë nuk na lishin kështu.

Anita Susuri: E kontakt fizik me gru s'keni pasë?

Agim Sylejmani: Jo, jo, jo, jo. Ato kanë qenë.

Anita Susuri: Çfarë fjalë për shembull ju kanë thanë familjartë ose kush ju ka ardhë në vizitë?

Agim Sylejmani: Më kanë ardhë mu t'gjithë, jo t'gjithë, edhe baba m'ka ardhë gjithmonë. Në çdo burg që kam qenë, më kanë dërgu edhe baba më ka ardhë edhe pse u kanë arsimtar. Edhe pse i jepsha sheja ktyne që mos të vijë ai, me rujtë në atë kuptim. Mirëpo, ai nuk është ndalë. Megjithatë, ai ka ardhë në çdo burg pa përjashtim. Se kryesisht e kom bo në Bosnje burgun në Zenice, Tuzla, Mostar, Foca, por çdokund ka ardhë.

Anita Susuri: E për shembull, më fal.

Agim Sylejmani: Nga torturat pra unë nuk i kam përjetu disa nga torturat, siç është shoku elektrik. Nuk e kom përjetu. Opium mu nuk m'kanë dhanë siç i kanë dhanë disa të burgosurve. Ka të burgostë prej tyne që për me nxjerrë diçka u dashtë me i dhanë edhe opiume, droge të ndryshme, çka po di unë. Është varja me kam në tavan, lakuriq e me kokë te poshtë. Edhe këtë s'e kam përjetu, s'guxoj ta them. Është edhe ni metodë e veçantë quhet regllazhë. Ashtu e kanë qujtë ata UDB-ashët, torturuesit. Në tavolinë e gjerë ku e zhveshin lakuriq e lishin kambë e durë edhe shkojnë dy vetë, tre, katër me

shkopinjë trupin tu ia rrah në çdo pjesë të trupit edhe t'u e rrotullu herë andej, herë andej. Domethonë, sikur në skarë kur pjeket mishi.

Kto tortura, tash kto që i përmenda i ka përjetu Rexhep Mala të gjitha këto i ka përjetu edhe Skender Kastrati i ka përjetu. Kta kanë qenë grupi i '75-tës. Nëse hasni në grupin e '75-tes me Adem Demaçin, nga të gjithë ata që kanë qenë të burgosur, vetëm dy vetë kanë ditë pse po bohen, pse po pysin edhe çka po pysin kta tjetër nuk kanë pasë haber për ato veç kanë qenë ish të burgosur politikë ma herët. Veç i kanë mbledhë kështu se Titoja ka thanë, "Unë i du njerëzit në burg. Kto punë që po i bojnë kta duhet m'i shti në burg të gjithë", edhe i kanë marrë. Se s'kanë ditë ku edhe i kanë marrë me listë kush ka qenë nëpër burgje. Edhe ka qenë aktgjykimi i montuar, '75-tës.

Mahmut Bakalli drejtpërdrejtë i ka udhëheqë hetimet, çdo natë ka shku në Sigurim atje. Kështu që, kta u dashtë me pranë, çka ju kanë thanë ata, kta u dashtë me thanë "Po", me pranë. Edhe andërr me pasë pa u dashtë me tregu. Domethonë, ka qenë ni nga gjykimet ma mostruozë që u bo ka qenë qiky i '75-tës, kur u dënu edhe Adem Demaçi. Ata nuk e kanë torturu Ademin, bile e kanë marrë në tetor në fund veçsa për me vnu...

Anita Susuri: Kapakun.

Agim Sylejmani: Kapakun kështu që me qenë ma bindës për opinionin, se jo për diçka tjetër. Se ai veçsa ka pasë dalë prej burgut në atë kohë, as nuk ka pasë mundësi me pasë lidhje me ato punë. E nga gjithë ai grup kanë qenë vetëm dy vetë që kanë ditë për organizatë, për të cilat punë edhe janë përgjegjë ata. Tjetër kanë pranë, s'kanë pasë qare se torturat janë zhvillu ato. E pikërisht në qit' grup ka pasë prej tyre që i kanë fut edhe në regllazhë edhe me kamë të varura në tavan. E pastaj me ujë të flliqtë, me harrë ia kanë fut në gojë e të gjitha gjërat. Ne veç mundemi me i pa qysh po bojnë ata në Guantanamo me të burgosun me ato ujna, me ato. Kto në Prishtinë i kanë bo të gjitha kto.

Anita Susuri: A kanë qenë kto lloje të torturave veç ni periudhë të caktume të kohës, tani kanë fillu si me thanë ma të lehta apo kanë vazhdu edhe ma tutje?

Agim Sylejmani: Grupi i '74-tës, fjala vjen, '74-tën kur u burgosë Kadri Osmani, Xhafer Shatri, Binak Ulaj e kta, kta e kanë pasë ni fat që pikërisht në këtë kohë u konë pas nalë tortura. Ka qenë çashtje fillimi i kushtetutës të '74-tës apo ka qenë ky liberalizimi apo ka qenë... në këtë kohë pastaj në '75-tën osht' edhe kjo Konferenca e Helsinkut. Diçka ka pasë të bëjë edhe kta kanë kalu ma lehtë. Tani në këtë kohë kur jom burgosë në '74-tën u burgosë edhe grupi i Partisë Komuniste të Rindërtuar a Partia e Re Komuniste e Jugosllavisë e malazezëve në Mal të Zi atje. Edhe i kanë bo ato paralelet i kanë tërheqë, as ndaj atyre s'kanë ushtru dhunë, po dënimet pastaj ia kanë dhanë maksimale.

E në '75-tën ka qenë gjykim i montuar. E pas '75-tës... pastaj ka pasë edhe në kohën e Rankoviçit ma herët thashë, deri aty, ato nuk po i bi në diskutim. Po prej '75-tës pastaj nuk u ndërpre, po ka shku t'u u

rritë, t'u u shtu dhuna. E '81-shi kanë pasë pastaj tortura të veçanta. E keni Hydajet Hysenin për shembull, në qoftëse arrini prej tij me nxjerrë me folë, ai ka aq...

Anita Susuri: E kemi intervistën.

Agim Sylejmani: Osht'... ai ndoshta edhe nuk ju tregon të gjitha, veç po të tregoj që atij i kanë dhanë çdo mjet të mundshëm. Ai nuk ka qenë në gjendje as me ditë ni kohë as ku osht', as çka osht'. Nuk ka mujtë as me ecë në kamë të veta, e kanë bartë me karrocë me rrota. Kështu që, varet kush sa nxjerrë nga përjetimet e veta, se janë shumë të randa, shumë të randa.

Anita Susuri: A keni pasë edhe ndihmë mjekësore për kto, pas ktyne rrahjeve për shembull?

Agim Sylejmani: (Qeshë) Më fal. E vetmja ndihmë mjekësore ka qenë që nëse je alivanosë të ka kontrollu, nashta bon vaki s'e ke pa hiç a osht', "Mirë i ka zemren e kto. Grahni!" Veç të kanë hedhë, të kanë hedhë ujë e kanë thanë, "Grahni, prapë!" (qeshë). Çfarë ndihme? Jo, ndihmë jo.

Anita Susuri: E tmerrshme. E po du me folë edhe pak për qito kushtet e burgut. Thatë që ni kohë keni qenë i izolim, pastaj qysh ka shku? Ju ju ka ra edhe me ndrru burgje shumë? Për shembull, herën e parë kur keni ndrru sigurisht as nuk ju paralajmërojnë që po e ndrroni burgun a diçka?

Agim Sylejmani: Jo, unë ma së pari nuk kom arritë me kuptu pse po m'lojnë vet edhe mas gjykimit në korrik. Në anën tjetër edhe kisha qef me nejtë vet për shkak të hapësirës. Unë thashë, ka pasë në dhoma tjera, se më tregojshin shoktë kur bishim në kontakt, kështu ka gjashtë vetë, pesë vetë me një dhomë që paramendo tash veç ni cigare me ndezë sa bohet ajo dhomë, ni dritare fare të vogël. Po në qoftëse pijnë katër vetë, pesë ti aty nuk ke mujtë me pa njani-tjetrin, nuk e shihnin. Tregonin shoktë, njani-tjetrin nuk e shihnin p'i tymit. Unë e kom pasë qat' fat, bile kom qenë vet.

Nuk është e lehtë me qenë vet, të kuptohemi a. Unë thashë kom pasë fat për shkak të kushteve të burgut të Prishtinës. Fillimisht m'kanë çu në Prizren, pastaj na kanë dërgu në Zenicë. Aty pastaj janë edhe disa kushte krejt tjera të paimagjinueshme për këtë brez, ka 150 vetë me ni dhomë me shtretër dy kat, tre radhë, katër me shtretër dy katësh të cilët punojnë në tre ndrrime. Tash llogarite natën ti do me fjetë, po vjen ai tjetri që ka me shku në punë ose vijnë prej pune. Aty shkon, duhet me u mësu ti me të gjitha të paimagjinueshme me nejt me tulifar kriminel. Neve nuk na linin ndaras prej të burgosurve tjerë. Kemi nejtë me kriminelë ordiner që ka qenë e tmerrshme.

Anita Susuri: Ju kanë përzi domethonë me...

Agim Sylejmani: Na kanë përzi. Neve na shpërndanin nëpër dhoma të tilla, nuk na linin neve me një dhomë si të burgosur politikë.

Anita Susuri: A ka pasë, për shembull të Kosovës që keni njoftë ju?

Agim Sylejmani: Unë kom pasë fat kur m'kanë dërgu prej ktu prej Kosovës për në Zenicë na kanë mbledhë nëpër burgje. Kom shku bashkë me këtë Faikun që kam qenë thashë, me këtë shokun e celulës edhe vllaun e tij. Te tretë na kanë dërgu në Zenicë. Aty kemi gjetë pastaj Rexhep Malajn, Sami Dërmakun edhe Adem Rukiçin. Kanë qenë aty kur kemi shku ne të burgosurit politikë, tani jemi bo gjashtë. Pastaj ndoshta meqë u bomë gjashtë edhe deshtëm me shfrytëzu me u bo meniherë ma shumë me e bo ni protestë. Bonim protesta ne me shkrim shpesh edhe organizonim greva urie.

Pastaj mirë po mu më hoqën meniherë prej aty. Kështu që, në Zenicë nuk m'ra me nejtë, ni muj e gjysë ma tepër. Pa i bo dy muj dhe më kanë dërgu në Focë. Aty e kam taku Skender Kastratin si të burgosur politik, domethonë ai ka qenë veç vet. Ma vonë pastaj e kanë sjellë Rexhepin se i patën shpërnda nga Zenica. Si patën bo protestën i patën shpërnda kështu në burgje të tjera. Të vetmin të burgosur të '81-shit e kemi pasë kta që osht' sot drejtor për Kshillin për të Drejtat e Njeriut, Bexhet Shalën. Në Sarajevë e kanë dënu atë edhe na sollën atë në '81-tën. Bile me qenë në kontakt me dikë të '81-shit.

Pastaj, për mos me na lonë me kontakt me kta të ritë, na kanë dërgu në izolim pa afat. Zakonisht izolimi jipej me ni vendim, për çkado qoftë ni muj, dy muj, maksimumi gjashtë muj ditë. Ta jipte ni vendim. Kur kalon ai afat duheshte me të kthy në burg. Mundte me të çu të nesërmen prapë, po prapë ta jepte ni vendim. Ndërsa neve na kanë dërgu nga Foca në Mostar pa afat, deri në fund të burgut.

Anita Susuri: Edhe keni qëndru deri në fund?

Agim Sylejmani: Deri në fund pastaj u dashtë me qëndru aty. Nga 23 shkurti '83-tes, '82-tes më fal deri në janar të '84-tës. Skender Kastrati ka ndejtë deri në '85-tën aty vetëm.

Anita Susuri: Më duket ju pyta për pesë vjet që keni qenë në burg, po a ju osht' zvogëlu numri në pesë vjet?

Agim Sylejmani: Jo, pesë i kom pasë, pesë kanë ngelë, nuk ka lëvizë.

Anita Susuri: Se ka që i kanë...

Agim Sylejmani: Po amnistioni kaniherë kur boheshite dikë e kapte amnistioni kështu, i hiqeshin ni vit a dy, dikujt a tri. Po, jo unë aq sa kom marrë, aq i kom bajtë.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë komunikimi mrena në burg? A jeni rujt, për shembull çka po flisni apo a ju kanë lonë me nejtë bashkë?

Agim Sylejmani: Në burg të hapur, në burg të hapur, po mendoj në burg të madh ka mundësi njeriu të takohet me njëri-tjetrin edhe varësisht çfarë niveli të organizimit je. Në qoftëse mrena burgut don me e mbajtë vetëm burgun, ti ke nejtë me kënd dush, ke kalu qysh të dush veç me kalu kohën. Unë thashë, kom pasë fat me qenë me disa të burgosur me të ciltë ne kemi vepru në burg, jemi organizu si celulë. Unë bile për këtë celulën ktu i kam disa miq që mirren me shkrime i kam sjellë disa libra ku mund t'i shihni.

Ne jemi organizu në burg si celulë, domethonë kemi vepru në celulë derisa kemi organizu celulën ne kemi vepru, kemi pasë takime të rregullta. Gjatë takimeve kemi përgatitë, jo meniherë me shku në celulë po me kqyrë sa jemi për ni celulë, a jemi të gatshëm a jo edhe kemi vepru nga burgu. Jemi marrë me shkrime. Përveç ngritjes ideo-politike tonën personale, njëkohësisht edhe kemi dërgu shkresa jashtë burgut. Jemi përgatitë për kur të dalim nga burgu. Që thashë, “Armiku na ka në dorë aq sa lejojmë ne vet”, kto janë ato udhëzimet {tregon disa dokumente me udhëzime}. Ne i kemi bo kto pastaj si broshura...

Anita Susuri: Kto janë shkru brenda?

Agim Sylejmani: Jo, kto janë broshura që i kemi kriju kur jemi dalë unë nga burgu. Kësisoqi i bonim kto librat e ndryshme për me i mshefë edhe me i transportu ma lehtë. Ose për shembull, “Zëri i Kosovës”, ne e bënim kështu {tregon një libër} për me e pru në Kosovë, që me pasë ma lehtë edhe me mshefë po edhe me bartë në xhep.

Anita Susuri: Sa ma të vogla.

Agim Sylejmani: Sa ma t’vogla, po. Natyrisht kto janë shkronja të imta, po për të ritë nuk osht’ problem. Për pleq, për mu po duhet me kqyrë me syze, po një i ri ose ni e re e lexon (qeshë) nuk o problem. Si celulë ktu ne {tregon një fotografi} tash është e montume kjo fotografi. Në fakt unë me Skenderin jemi fotografu në burg pasi ka dalë Rexhepi nga burgu. Ky, më fal se gabimisht {tregon me gisht tek njëri person në fotografi}. Rastësisht ne kemi kërku fotografi kështu për indeks edhe për patent shoferi. Ne veç e kemi kërku se punojshim disa vizatime ne atje në burg i zmadhonim fotografitë edhe pasi që na bonën fotografitë veç na u tekë me i thanë, “Po a bon edhe ni fotografi bashkë”, po nuk e kemi besu që na japin fotografitë.

Anita Susuri: Brenda në burg?

Agim Sylejmani: Brenda në burg në Mostar, para se me dalë. Kështu që, kjo fotografi është origjinale ktu pastaj djali im e ka fut’ edhe Rexhepin e ka bo tre. Vetëm kjo është e montume ktu. Kjo është fotografi kur u dalë Rexhepi nga burgu, se ky ka pasë këtë mjekërr. Në burg nuk lejohet mjekërri. Kur i bishin popat ma s’pari ua hjekshin mjekërren komplet, tani i futshin mrena. Ky Rexhepi e ka bajtë. I

vetmi i burgosur politik që ka bartë mjekërr edhe me këtë mjekërr ka dalë. Kjo fotografi është e Mostarit kur u dalë nga burgu ka bërë fotografinë, pastaj e ka hjekë mjekërrin.

Anita Susuri: E pse janë bo kto fotografi? Si kujtim apo ndonjë procedurë?

Agim Sylejmani: Jo, unë thashë, kjo rastësisht kemi bo këtë fotografi unë, Skenderi brenda burgut. Nuk e kemi besu që na lejojnë. Ma vonë pastaj Skenderi edhe ka arritë, masi kom dalë unë ka arritë me fut ni aparat fotografik në burg, me fotografu shtratin në burg në atë dhomën e tij ku ka qenë edhe ku ka fjetë qiky Rexhepi. E ka fotografu edhe atë vend. Ka qenë ni... kemi pasë tentu na ma herët, po nuk kemi arritë me fut aparatin mrena. Ky Skenderi pastaj ka arritë me fut aparatin mrena edhe ka bo fotografim edhe u fotografu vet.

Mirëpo, fotografi me Rexhepin nuk kishim kështu që e kemi bo tani montazhë. E kjo fotografi osht' Rexhepi kur ka dalë nga burgu kështu me mjekërr. Disa ktu kanë, kanë fillu kshu me ia bo qefin ktyne të hujve, "Jo, po kta thojnë mjekërrin s'pe kanë qef", po atëherë duhet me ia hjekë mjekërrin edhe Adem Jasharit na. Kta nuk parapëlqejnë. Ky e ka bartë edhe gjatë ilegalitetit mjekërrin edhe në burg, katër vjet...

Anita Susuri: A ka qenë si shenjë proteste a?

Agim Sylejmani: Jo, jo. Ka qenë, ka pasë problem i futeshin brenda kështu. Gjithmonë bëheshte varrë ksajde, infektohej edhe ia lejunë mos me u rru, por veç me u qethë. Edhe tani dalëngadalë nuk e qethshim hiç (qeshë) e ka lshu kështu mjekërrin. E ktu është ni vizatim, në këtë roman se ky është prapë jeta e Rexhepit në një roman prej lindjes deri te vdekja. Ktu është me vizatim betimin kur e kemi bo mrena qelisë së burgut. Veç thashë ta sjellë ndoshta është me interes, ua kom sjellë me ua dhonë në fakt këto po...

Anita Susuri: Nëse doni me i tregu nuk është problem.

Agim Sylejmani: Jo, deshta me i tregu. Taman siç është ktu në vizatim {tregon një vizatim në një libër} kështu kemi bo betimin në burg.

Anita Susuri: Para Enver Hoxhës a?

Agim Sylejmani: Po. Vizatimin e ka bo Skender Kastrati, se osht' gjallë akoma muni me pytë ju tregon (qeshë). Ai osht' gjallë, une, Rexhepi s'osht', por Skenderi osht' gjallë. Flamurin e kom bo unë. E kom pasë flamurin, e kom pasë punu nifarë plishi atje në burg edhe...

Anita Susuri: E keni punu në burg flamurin a?

Agim Sylejmani: Po, e kom bile e ruj atë...

Anita Susuri: A s'ju kanë konfisku, a diçka?

Agim Sylejmani: Jo, si album. Albumin e kom mveshë me plish edhe e kom bo flamurin. E pata bo një ksi shpërpllake kështu, tani e kom pasë pre edhe e kom ngjyrosë. Ka dalë ni punim i bukur. E ruj kështu se e kom të vetmin kujtim nga burgu. Kështu që, ne kemi vepru në burg në mënyrë të organizume edhe jemi përgatitë se çka na pret, drejtimet çka do të veprojmë jashtë.

Gjatë burgut për këtë qëllim edhe kemi mbajtë shumë kondicion, jemi stërvitë. Në kohën kur tjetër flinin, ne jemi zgju në ora 4:00-4:30 [të mëngjesit] gjithmonë. Derisa zgjoheshin tjetër, ne kemi bo stërvitjet. Tash unë muj veç me dëshiru ni kondicion të tillë. Jashtë nuk e kom pasë kondicionin që e kom pasë aty. Domethonë, kemi qenë të përgatitun edhe fizikisht. Mirëpo, tani Rexhepi osht' vra me 12 janar [1984], unë jom dalë me 14 janar, dy ditë pastaj. Nuk na ka rastisë, nuk kemi pasë fat të takohemi.

Anita Susuri: Qysh e keni pritë ju këtë lajm?

Agim Sylejmani: Ka qenë shumë e randë. Une fat kom pasë që kom qenë me Skenderin n'qatë kohë aty. Me pasë qenë vet, nuk muj me imagjinu. Kjo osht' ni figurë prej ma të mdhajave që ka pasë Kosova. Kështu që, njeriu që ka bo ma së shumti, ky si 17 vjeçar ka drejtu demonstratën në '68-ës në Gjilan. I turturum, që krejt kto turtura që unë s'i kom përjetu që i përmenda, ky i ka përjetu të gjitha. Edhe nuk e ka dhanë asni shok, asni sekret të organizatës nuk e ka dhanë. Të tjetër kanë vazhdu pa kurfarë problemi edhe me fjetë në gjumë të qetë edhe me vazhdu pa pasë frikë që dekonspiron. Ka bo burg shumë të randë, mrena tetë viteve i ka mbi gjashtë muj i ka greva urie. Ti rri dy ditë, tri pa bukë shife si osht'.

Kështu që, osht' ni figurë që pak bëhet për të. Asni shkollë nuk e ka, përveç me ni fshat në Topanicë që asgjë nuk lidhet me Rexhepin ia kanë vnu atje ni shkolle, asni shkollë nuk ka emrin e tij. Ktu nuk ka përmendore fare. 70-80 metra ma poshtë është e Shyt Marecit, ky osht' vra me Nuhi Berishën atje lart ka luftu me polici ni natë edhe nuk kanë përmendore. Nuk kanë as bust, nuk ka as vend. Bile me ni shpi krejt tjetër kanë vu ni pllakë që nuk ka të bëjë me atë ngjarje, se dola prej temës më fal por veç sqarim.

Anita Susuri: S'osht' problem, me rëndësi është edhe kjo. Po, po du me u kthy te burgu me ju vetë, domethonë, keni qenë goxha larg atje në Bosnje, a keni pasë edhe atëherë vizitë prej familjes?

Agim Sylejmani: Po, na kanë ardhë në vizita. Çdo muj kena pasë vizitë. Kjo ka qenë ajo mbështetja e madhe që na ka... se të udhëtosh çdo muj, tash llogarite ni rrogë nuk ka dalë me bo ni vizitë. Domethonë, sakrificat të mdhaja kanë bo familjartë. Kjo ka qenë ajo që na ka majtë moralisht në burgje, kanë qenë familjet tona.

Anita Susuri: Osht' edhe ni aspekt tjetër, ni vështirësi tjetër për familjen kur për shembull ju ndoshta keni qenë burim financiar ose dikush tjetër i familjes...

Agim Sylejmani: Unë s'kam qenë burgim financiar, po unë jom bo pastaj ni pengesë e madhe për familjartë tjerë. Kta nuk kanë mujtë me hi në punë, përveç baba. [Atë] Nuk e kanë ngacmu meqë matematikë, nuk e kanë ngacmu ai s'osht' marrë me çashtje politike edhe e kanë leju me punu, thjeshtë. Po fati ka qenë që ne ktu në Prishtinë kemi qenë afër menzës edhe kemi pasë qiraxhi edhe studenta, ka lshu baba. Domethonë, kanë qenë ni burim i të ardhurave megjithatë. Po kta tjetër e kanë pësu nga unë. Si vllau që s'ka mujtë me hi n'punë kërkund, motra gjithashtu, gruja qashtu edhe pse kanë kry fakultetin nuk kanë mujtë me hy n'punë.

Si tinëz e kanë fut, tani në '83-tën ni zavëndesim në fakt si profesoreshë e gjuhës ka shku në shkollën "Zenel Hajdini", po ni kohë të shkurtë. Kur dola nga burgu '84-tën, si e morën vesh e kujt osht' e largun meniherë. Domethonë, ka qenë ajo. Familjartë e kanë psu me vende pune ose degradim në vendin e punës ose largim nga puna ose nuk i kanë lanë me hi fare. Kështu që, përveç babës, kta tjetër e kanë pasë goxha problem. Unë e kom ndje gjithmonë nifarë lloj përgjegjësie si shkaktar demek për atë, por edhe pse ka qenë për të gjithë nisoj, për të gjithë ka qenë nisoj sistemi i tillë ka qenë edhe...

Anita Susuri: A ju kujtohet dita kur keni dalë prej burgut? Kanë ardhë familjartë me ju marrë apo si?

Agim Sylejmani: Jo, jo, se larg. Unë thashë, ka qenë larg. Unë ju kom thonë mos me ardhë me më marrë se edhe larg edhe ka qenë dimër. Nuk dihej, me 14 janar shembull, mundej me qenë kumeditë çfarë kushte në rrugë situata m'i ndodhë dikujt diçka ndjejsa ni përgjegjësi të madhe. Kështu që, kam ardhë me, deri në Sarajevë kom shku prej Sarajeve deri në Shkup e prej Shkupi në Shkup kanë dalë më kanë marrë pastaj.

Anita Susuri: A keni pasë mjete me udhëtu?

Agim Sylejmani: Më kanë dërgu familja, më kanë dërgu. Unë thashë familjet kanë sakrifiku shumë. Meqë ktu tash po flas, po e boj ni degresion ktu kohor po kthehem te hetimet ktu në Prishtinë. Kta e merrnin lejën për me na sjellë ushqim, se me marrë vijë ajrore nuk i kom nga shpija as 300-400 metra. E merrnin lejën me sjellë ushqim edhe shkonin e nxirrnin piten prej shporetit, domethonë kur vinte me durë s'mujsha me marrë qaq njetë me vijke pitja. Këtë lluks nuk e kisha kur m'kanë largu nga Prishtina. Po kta kanë bo shumë. Unë edhe e ha amelsinën, shumë shpesh m'kanë pru edhe bakllava aty. Kta vet ndoshta nuk kanë pasë për veti, po për mu m'kanë da. Jo veç mu, gati pa përjashtim të gjithë të burgosurve politikë, familjartë kanë lanë vetën keq për diçka po të burgosurve ju kanë dërgu.

Anita Susuri: A ka pasë ndonjë rast që ju kanë ndalë? Se ka ndodhë edhe me ju ndalë ose ushqimin ose...

Agim Sylejmani: Po ka pasë raste, ka pasë. Sidomos ma së keqti ka qenë kur neve na kanë dënu me izolime, me vetmi, si ni lloj dënimi që kena pasë për mos respektimin e rendit shtëpiak. Shpesh ka ndodhë që vishin familjartë edhe deri te burgu u kthejshin pa na pa fare. Fillimisht ka qenë problem jashta Kosovës me folë shqip. Të burgosurit gati pa përjashtim, tek-tuk ndoshta, unë s'kom dëgju po mund t'ketë naj rast që ka folë serbisht po kryesisht nuk kanë folë serbisht. Kështu që, në raste të tilla familjartë veç janë ardhë e janë kthy pa i taku fmitë e tyre apo pjesëtarë e tyre. Ma vonë pastaj me këtë rezistencë të të burgosurve janë detyru me siguru gjithmonë tani përkthyes. U dashtë me lajmëru kta telegrafi, me telegram, telegrafikisht se po vijnë në vizitë edhe ata siguronin përkthyesit. Përkthyesit e vet natyrisht policë kanë qenë zakonisht, shqiptarë policë.

Anita Susuri: Deshta me, ju më tregutë që pas burgut keni fillu prapë me aktivitete. Po më intereson si ka ndodhë kjo? Si keni hi prapë në rrjedha?

Agim Sylejmani: Unë jom dalë thashë me 14-tin, Rexhepi u vra me 12-tin, Kadriu daja im osht' burgosë qat' ditë se ka qenë me kta dy bashkë, se kanë qenë bashkë kta. Si janë dalë prej burgut kta meniherë kanë fillu bashkë te dytë edhe pastaj me Nuhi Berishën, ju ka bashkangjtitë edhe Nuhiu ktyne. Kështu që, kur jom dalë unë faktikisht nuk e kisha asni vegzë ku të kyçem edhe pse ka qenë shumë shpejt. Nuk i kishte, nuk i kishte as pesë ditë që ish vra Rexhpi kur i kom thanë grusë të Rexhepit, Hanifes, "Hanife, nëse ka ngelë najkush ktu ma dërgo [kontaktin] që të lidhem meniherë". Nuk mujsha me imagjinu me nejtë.

Kështu që, kam fillu meniherë. Ajo ma ka sjellë ni lidhje t'ni shokut, Sami Abdullahu, i Shurdhanit, fshatit Shurdhan. Djali i atij që thashë, sa herë i kanë lypë fmitë Hasipit edhe djali i tij domethonë, i treti me radhë i bjen. Jom lidhë me të fillimisht. Në këtë kohë pastaj del nga burgu edhe Pajazit Jashari, ky që e pat' ikë nga Goliotoku, nuk e di a e keni taku këtë. Ai ka qenë bile si i mitur në '81-shin me Gjyle Krasniqin bashkë ni grup, "Shota Llapi", që i kemi thanë ne. Kanë qenë në burg [ai], e në '84-tën ka dalë nga burgu ky Pajaziti në mars.

Anita Susuri: Pajazit Jashari?

Agim Sylejmani: Pajazit Jashari osht' në Podujevë, osht' ni djalë shumë i mirë. Kështu që, meniherë kemi fillu na. Pa i bo, kur jom dalë nga burgu, pa i bo dy javë faktikisht unë kom fillu me aktivitet. Edhe kom fillu prej zeros, se thashë, ni pjesë e madhe kanë qenë në burg, ni pjesë kanë arritë m'u arratisë, disa kanë qenë të vvarë. Kështu që, kom fillu nga zero për me u kapë ku kanë metë. Kanë pasë metë në këtë periudhë që po flasë kanë pasë metë si gusa në mjegull njerëzit që kanë qenë të lidhun, shkëputjet janë kriju shumë.

E kam arritë tani nëpërmjet ktyne shokve m'u lidhë tani edhe me jashtë për m'i kërkju lidhjet ku kanë ngelë. M'i fut njerëzit m'u lidhë mes veti, m'u ditë ku janë, në këtë kuptim. Jom marrë pastaj me disa shokë ktu në Prishtinë, në Gjilan, në Lipjan, në Ferizaj, në Kamenicë, në Podujevë. Domethonë, këtë

teren e kom mbulu. Pastaj kemi dalë edhe në Zhur atje me Ismet Badallin. Edhe kom fillu me krijimin e Komiteteve Lokale. Kemi kriju disa Komitete Lokale në atë kohë me tentim të riorganizimit të OMLK-së edhe e kemi qujtë qashtu OMLK-ja e riorganizuar.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Vazhdum me folë për periudhën e...

Agim Sylejmani: Pas burgut.

Anita Susuri: Pas burgut, po deshtët, më thatë që deshtët me shtu diçka për në burg në Foce.

Agim Sylejmani: Deshta ma tepër një informacion për brezin. Nëpër burgje, thashë, nuk na linin as me folë shqip nëpër vizita dhe letrat dojshin që t'i shkrujmë serbisht. Rezistenca e të burgosurve pat' arritë me kriju kushtet e vizitave në gjuhën shqipe, por edhe letrat m'i shkru shqip. Në bibliotekat e burgjeve nuk ka pasë libra shqip. Përpjekja e vazhdueshme e disa të burgosurve ka pasë arritë në shumë burgje të ketë edhe literaturë në gjuhën shqipe. Siç ka qenë, për shembull, duke filluar nga Burgu Idrizovës, ku natyrisht pas shumë e shumë grevave të urisë të vazhdueshme, pas protestave të vazhdueshme kanë arritë me kriju ni fond bukur të mirë të librave në gjuhën shqipe.

Të njejtën gjë është bë edhe në Foce që kam qenë edhe unë pjesë e qatyre përpjekjeve. Me Skenderin e Rexhepin i kemi bo edhe grevat të vazhdueshme po edhe kemi arritë që ta detyrojmë burgun apo drejtorinë e burgut që aty të na sillnin edhe libra shqip. Kanë qenë mbi 350 tituj shqip. Kemi arritë që të na lejohet edhe televizioni. Të mërkureve jipte Beogradi, Prishtinën jipte, me, [TV] Beogradi 2 më duket mos gabofsha tash, jipte lajmet e Prishtinës. Kështu që, patëm kërku të mërkureve t'na lejohet me dëgju edhe lajmet e televizionit në gjuhën shqipe. Mirëpo, kto janë bo me shumë përpjekje. Osh't' dashtë me greva të tana me kah dhetë ditë 15 ditë grevë urie.

Në grevë urie tash m'varet se kto grevat uritë janë qeshit qeshit që po i shohim kaniherë ktu. Edhe kur janë bo greva urie, po ju kanë çu pite edhe flija nëpër ato greva (qeshë). Ne vetëm ujë kemi pi, po ushqim jo. Presioni nëpërmjet grevave ka dhanë rezultatin e vet edhe janë furnizu bibliotekat. Të burgosurit kur kanë shku pastaj në '81-shin në Foce e kanë gjetë bibliotekën e gatshme me literaturë të bollshme. Qashtu edhe po të njejtën gjë edhe në Idrizovë edhe në disa burgje tjera. Kjo është sa për me ditë që burgjet nuk kanë qenë të furnizume, po është dashtë me hjekë shtesë diçka tjetër me përjetu diçka ma të randë nëpër vetmi edhe izolim të disa të burgosurve për m'u arritë edhe furnizimi me literaturë shqip.

Anita Susuri: Kem t'u folë edhe për periudhën pas burgu...

Agim Sylejmani: Pas burgut po.

Anita Susuri: Edhe thatë që meniherë keni dashtë me u rikthyer me aktivitete, qysh ka ndodhë krejt kjo?

Agim Sylejmani: Siç e thashë unë, pas dy dite, tre, kom kontakt me grunë e Rexhep Malajt edhe i kam kërku që t'më vëj në kontakt me dikë nga ata që kanë ngelë pa u arrestu ose pa u arratisë. Edhe më ka, edhe e përmenda, që m'ka lidhë me Sami Abdullahun fillimisht. Samiu ka rastisë që me e taku Pajazit Jasharin në burgun e Gjilanit, kështu që Pajaziti ka dalë pikërisht në këtë kohë, në mars dikund. Kështu që, kanë fillu prej asgjëje, prej zeros. Edhe duke gjurmuar ku janë, sikur kur, osht' pak e pashpjegueshme ndoshta e paimagjinueshme si kemi dalë me i gjurmu njerëzit që kanë mbetë edhe pse ilegalitet i thellë i tillë, po ne kemi gjurmu ku kanë mbetë lidhjet e shkëputura.

Kam pasë mbështetjen nga jashtë ata që kanë dërguar lidhjet jashtë që kanë ditë dikush nga dikë. Kemi marrë këto lidhje nga jashtë me parulla të ndryshme të njohjes me ta. Secili ka pasë parullën e vet me të cilët me ato parulla pastaj kemi shku i kemi kërku njerëzit. Siç është e përmenda, për shembull, në Zhur kam shku te Ismet Badallaj. Ka pasë ni parullë, kam shku te shpija e tij nëpërmjet parullës. Faktikisht kam kriju lidhjen me të ksisoji, pastaj kemi vazhdu. Unë thashë, me disa shokë pastaj jemi marrë kryesisht me riorganizimin e OMLK-së. Po në të njejtën kohë kanë vepru shumë grupe në atë kohë në Kosovë, jo veç një. Kanë mbetë shumë të shkëputur që kanë vepru në vete.

Kanë vepru deri në dhjetor '85-tës ktu në Kosovë, se kam qenë në ilegalitet, këtë, harrova të them që pas një kohe jam detyru me dalë në ilegalitet të thellë kur osht' paraqit rreziku i dekonspirimit tim personal në atë kuptim. Edhe për masa sigurie jam largu nga shtëpia pak ma herët, në fakt kisha pasë të drejtë. Kemi pasë banesa ilegale me të mshefta që janë marrë në emër të dikujt tjetër e është dashtë me shku. Unë në këtë rast, ni bazë e kemi pasë në Dragodan, ni shtëpi, ni Ahmet Krasniqit, ni punëtorit, punëtor krahu ka qenë ai. Ni shtëpi kështu përdhesë.

Aty e kom pasë strehimin tim kryesorin, se kom pasë shumë banesa, kemi pasë, po aty e kemi pasë edhe si bazë. Kemi pasë edhe teknikën e shumëzimit e kemi pasë atje, makinën e shkrimit e të gjitha kemi pasë bazë aty. Ka qenë bazë edhe për në rast se rrethohet me pasë me çka me luftu aty, domethonë deri të asgjësohen. Bile mos me dekonspiru njerëzit. Çka edhe e vërtetoi pastaj me rrethimin e Pajazit Jasharit, Selatin Abdullahut edhe Fadil Lepajës në mars në '86-ës. Pikërisht qato mjetet që i kanë disponu ua kanë mundësu kohën për me asgjësu çdo gjë.

Anita Susuri: E ju, kur jeni ra në burg keni qenë në përfundim të vitit të dytë në fakultet...

Agim Sylejmani: Po, më kanë ngelë edhe dy provime.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu pastaj?

Agim Sylejmani: Po ka qenë ni listë e kuqe i thojshin. Listë që janë ndalu studimet. Unë e kom regjistru me korrespondencë, nuk e di tash saktësisht qysh e kom rregullu, nëpërmjet dikujt është rregullu kjo se ka qenë si në mënyrë të msheft nifarë mënyre. Po regjistrimin e studimeve dojsa me kamufllu futjen në fakultet, që me pasë kontakt, ku jom taku edhe me tjetër pastaj. Si, aty m'ka rastisë me u taku me Sherif Konjufcën, fjala vjen, në fakultet. Ai ka qenë në drejtësi unë kom qenë në ekonomik. Po jom taku me Bashkim Mazdrekun e me shumë tjerë që kanë qenë studenta aty.

Kamufloja gjoja po shkoj me mësu në bibliotekë të fakultetit për me pasë kontakte ma natyrshëm. Ku e kishim mundësinë edhe me bo përcjelljen kush po futet e kush osht' aty, jo qaq haptaz, në mënyrë konfidenciale. Kam dhanë ni provim, sa me thanë që po hy në provime, se nuk ka qenë ma qëllimi i vazhdimit të studimeve në fakt se nuk kisha kohë. Jashtë m'u ka pamundësu me vazhdu studimet se Zvicërra dikush e njohin shumë demokratike po nuk ka qenë qashtu qysh e mendojnë tjetër (qeshë). Kështu që, nuk m'kanë pranë me, nuk m'kanë leju me shku në universitet...

Anita Susuri: Për shkak se keni qenë ish i burgosun?

Agim Sylejmani: Jo, jo, për të hujtë, për të hujtë ka qenë rigoroz, kanë qenë shumë rigoroz për të hujtë. Unë kam qenë pjesën gjermane, kta që kanë qenë në pjesën franceze, kta kanë... edhe pse osht' Zvicërr, i njeiti vend, kta kanë mujtë të vazhdojnë studimet sikur Ramadan Avdiu, Bardhyl Mahmuti. Kta të gjithë kanë mujtë me shku në fakultete m'i mbaru studimet, po në pjesën gjermane jo. Andej nuk ka qenë e mundshme.

Prandaj jam detyru, pas lufte bile, kam shku e kam përfundu ni shkollë të lartë në Institutin Limperg në Hamburg, si këshilltar pedagog kundër dhunës që ushtrojnë burrat. Tani kom punu si këshilltar kundër dhunës me ni institut qaty në Lucern. Po ma kanë pasë pamundësu. A ktu, ktu nuk ka qenë, edhe nuk kisha mundësi i rregullt me u regjistru ashtu ashtu, po veç sa për sy e faqe me pasë ni arsye me shku në fakultet.

Anita Susuri: Domethonë nuk keni arritë me diplomu?

Agim Sylejmani: Jo, jo, më ka ngelë në gjysmë, po. Por në punë nuk m'kanë leju me hy. Kam kërku edhe si pastrues në [Organizatën Ndërtimore] "Ramiz Sadik", kam kërku me hy në Minierë të Trepçës. Mirëpo kanë qenë disa lista që mos me i lonë me shku te punëtortë. Si duket kam qenë edhe une se nuk më kanë pranë askund. Arsyetimi, "Ke shkollë ma shumë sesa që kërkohet", gjimnazi edhe nja dy vjet fakultet, nuk i pranojshin edhe...

Anita Susuri: E në minierën e Trepçës çka keni kërku?

Agim Sylejmani: Si minator poshtë. Jo, jo qëllimin e kisha m'u fut te minatorët, ishte me sherr edhe ajo (qeshë). Qëllim, jo me sherr, po me qëllim të caktuar kështu që me qenë në mesin e punëtorëve. Kanë pasë atë kujdesin që m'i lanë sa ma larg studentave, sa ma larg punëtorëve.

Anita Susuri: Vitet e '80-ta, fundi i '80-tave ka qenë plot me ngjarje ku fillon edhe ky marshi i minatorëve që fillon edhe krejt marshet tjera me ardhë në Prishtinë e këto paknaqësitë me u shpreh për këto ndryshimet që janë bo. Me thanë, stafi që e ka udhëheq politiken kosovare. Qysh ka reflektu krejt kjo te puna e juj?

Agim Sylejmani: Pikërisht qikjo çka je t'u folë tash osht' shkak që u bo kjo monografi {tregon një libër}. Ky është ni, ka qenë djalë i ri, bokser. Shkaku i boksit e ka lonë edhe shkollën e mesme. Ka qenë edhe kampion Kosove në '81-shin. '89-ta ngelet ni, ta quj, mister për opinionin. '81-shin janë vra dymbëdhjetë vetë, kujtohen vazhdimisht, shkruhet për ta, flitet për ta. '89-ta ka pasë me dhjetra e dhjetra të vvarë. Unë e kam gjetë ni listë vetëm me 23 mars deri në maj '89-ten, 57 të vvarë. Me qindra janë të plagosur, me mijëra janë të burgosur. Nuk flitet. Marsi kaloi. A ke dëgju ndonjë material për këto? Pikërisht ka qenë kjo që më ka preokupu.

Tash po të tregoj si e kemi përjetu ne. Nuk e kapte Prishtinën, valtë e Prishtinës nuk i kapnin dot radio edhe dilnim me gruan me veturë ku e kishte valë vetëm hypnim në trotuarë me veturë edhe rrinim aty. Nxet', ftoftë, shi ne rrinim aty në veturë derisa të mbarojnë lajmet. Osht' kohë që edhe kom majtë ditat të rregullt për çdo ditë. Domethonë, me kto që kanë të bëjnë, me ngjarjet ktu çka zhvillohen. Kështu që, e kisha një mundësi që këto ngjarje t'i fus ktu në formë kronologjike, në formë telegrafike me ia bashkangjitë, m'i inkorporu me ni biografi që ne te dijnë brezi çka ka ndodhë në '89-ten edhe pse nuk flitet për '89-ten.

A mos në '89-ten filloi apo ka fillu pak ma herët siç e përmendet ju atë punën e marshimit. Pse ndodhën këto marshimet? Pse ecën njerëzit me 50-60 kilometra deri në Prishtinë? Pse ia futshin në dorë ni fotografi të Titos, "Hecni deri atje", kur fotografinë e Titos gjithandej e hudhnin poshtë. Nuk e mbante as në zyre askush nëpër Jugosllavi. Futshin flamurin e Jugosllavisë kur tona antë në Jugosllavi e hidhnin në tokë flamurin e Jugosllavisë. Gjithë ajo energji e akumulume për vite tana u harxhu për karrige të dy-tre vetve. Ndërsa kta vet kanë qenë shkaktarë të gjithë që kanë qenë pushteti i kaluar, shqiptartë e kom fjalën. Kanë qenë pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në ndryshimet kushtetuese.

Nëse hyni vetëm në, "Rilindje", edhe pse ka qenë autoparlant i regjimit, "Rilindja", osht' shkru shqip po megjithatë... aty vetëm m'i shfletu ato gazeta e sheh se çka ka ndodhë në fakt. Kush kanë qenë ata iniciatorë? Kush ka qenë në këtë komision kushtetues? Çka kanë thanë nëpër këto organizata punonjëse për ndryshimet kushtetuese? Gjithë kanë dhanë miratimin pa ditë çka po thojnë. Çdo gja çka osht' kontestuese ia lojnë komisionit. Komisioni kishte kohë që i kishte harmonizu të gjitha gjërat me ata. Domethonë, ka fillu që në '87-ën e knej, edhe ma herët po '87-ën fillon definitivisht me ardhjen e Millosheviqit në Fushë Kosovë. Kush ia mundësoi? Azem Vllasi. Sot na del neve këtu analist.

Në fakt, po a pat' ni fotografi se kam përdorë qat' fotografi pikërisht në... shifni këtë fotografi këtu {tregon një fotografi} Milloshi ktu ku shkon, Millosheviqi atje në Fushë Kosovë. Askush nuk qeshë. Shifeni sa i knaqun, i gëzun është Azem Vllasi se e ka kry misionin e vet. Edhe kta kanë mujtë me qeshë që kanë ardhë, asnjë nuk qeshë vetëm Azemi. Domethonë, ky edhe në qit' kohë ka qenë në shërbim të tyre. Edhe ato marshime kanë qenë krejt në shërbim të, me u marrë me marshime ndërsa në anën tjetër kanë vepru që i kanë dashtë. Po nuk është vra askush.

Kuvendi që e suprimon autonominë, ka qenë tetor, nëntor gati 75 përqind i zëvendësuar. Se kanë pasë do mënyra tjera kanë qenë të zgjedhjes së delegatëve ma përpara nuk ka qenë kështu me votime sikur tash. Me 23 mars ata e suprimojnë autonominë. Të njejtë njerëz janë që e shpallin pavarësinë në '90-ën, asnjë nuk është fut në burg. Ai e ka shpallë pavarësinë na veç me shkru, "KR-Kosova Republikë", merrnim disa vite burg. Ndërsa kta e shpallën pavarësinë, s'futen në burg. Shpallin deklaratën e kushtetuse në Kaçanik, kërkush nuk hin në burg. Ndërsa kta që donin me e mbrojtë autonominë, kta i vrisnin si kingjat.

Radio Lublana thotë, "Mbi 140 janë vra". Na nuk dëgjojmë askush, nuk flet askush. Të gjithë kta që kanë qenë akterë të ktyne ngjarjeve, të gjithë janë të sistemuar në nivelet ma të larta të shtetit, prandaj nuk flasin. Ne kto i kena përjetu shumë randë, jo vetëm marshimet. Si sot më kujtohet kur ktu në Prishtinë, Remzi Kolgeci ju thotë, "Ju garantojmë që në mbledhjen e parë kena me i shqyrtu kërkesat e juja. Shkoni nëpër shpija se s'po mujmë me punu na prej zhurmës të juv". I mashtrun, i tradhëtun, ashiqare. A i shqyrtun naj herë kërkesat e minatorëve ose punëtorëve, jo. Domethonë, i mashtrun. Kemi përjetu na shumë rond atje. Siç thashë unë kom mbajtë ditat, kur i shoh kaniherë më kthen meniherë mrapa aty për 30 vite mrapa më kthen. Kanë qenë shumë vite të randa për neve jashtë. Se me qenë ktu shkon kjo, me njëri-tjetrin tejkalohet ma lehtë. Nga jashtë është pak ma e randë...

Anita Susuri: Po në këtë periudhë ju keni qenë jashtë Kosovës apo?

Agim Sylejmani: Kom qenë jashtë, kom qenë jashtë pikërisht. Vjen pastaj '90-ta, jo, ni segment në '89-tën vriten kaq shumë njerëz, në '89-tën kur është represioni ma i madhi i mundshëm në Kosovë se ka qenë gjendje e jashtëzakonshme, nuk e di sa e dini ju atë situatë në atë kohë. Ka qenë edhe orë policore edhe gjendje e jashtëzakonshme, kanë ardhë edhe forca të reja të ushtrisë edhe të policisë prej gjithë Jugosllavisë këtu. Vendi i parë ku lejohet pluralizmi politik është Kosova. Ku për herë të parë krijohet ni parti Lidhja Demokratike e Kosovës, me ni vend ku faktikisht ia kanë marrë çdo gja. Kërkush nuk e mendon, pse u kriju këtu ni Lidhje Demokratike në atë kohë? Pse e lejun këtu te na? Në njanën anë i kanë vra të ritë gjithandej. Veç Familja Badalla atje në Zhur tre-katër vetë për ni ditë i kanë vra ata të ri.

Pastaj kalon nifarë qetësie, filloi kta, pushteti paralel, që e qunin sikur po e drejtojnë kështu masën edhe ranë vrasjet për ni kohë. Mandej, prej janarit '90 nuk ka pasë shumë vrasje, vetëm prej ushtrisë që

i kanë sjellë të vrarë, se kanë bo politikë paralele, në atë kuptim, për me ra qikjo mllefi te poshtë. Kta kërkush nuk e përmend. Mu më dhënë shumë kur dëgjoj, kur nuk dëgjoj kërkund me u dhanë njoftimi për këta njerëz. Është edhe një djalë nantë vjeç i vrarë, Agim Murtezi, ni djalë në Gjilan. Kërkush nuk e përmend kërkund, nantë vjeçar ka qenë, por nuk e përmendin. Shkaku është që duhet me folë tani pse u bo '89-ta, çka ishte para '89-tës, kur filloi. Kështu që, në këtë periudhë, qët' periudhë unë e kom përjetu jashtë. Ka qenë shumë e randë për të gjithë. Ma kur filloi greva, ajo ka qenë, na nuk e dijsim që kta po hajnë pite edhe flija nëpër greva. Po grevë urie edhe na ishim mësu grevën mos me shti në gojë kurgjo.

Kështu që, për neve ka qenë shumë e randë. Qët' kohë motra ime ka qenë shtatzanë me binjakë. Nga vaji që ka bo edhe mërzia që ka bo çdo ditë ato ditët e grevës ajo u deshtë me dështu. Kështu që, po du me thanë, kjo ndjenjë këtu për kta të grevës. Por llogarite që tash ne jashtë me lajme ma të ndryshme ballafaqoheshim, kanë qenë të randa. Kjo ka qenë ni periudhë shumë shumë e vështirë, se ndryshe është, e ke pushken në mal, shumë e lehtë është. Ti ke pushken në mal, ai kqyrë me të vra, ti kqyrë me vra tungatjeta. A ksisoji, kjo osht', gjendje shumë e tmerrshme.

Anita Susuri: Deri në cilin vit ka vazhdu aktiviteti juj në OMLK? A keni vazhdu edhe jashtë kur keni qenë?

Agim Sylejmani: Po, kom vazhdu meniherë, kom vazhdu meniherë. Unë nuk e kom ndërpre kurrë.

Anita Susuri: Keni dërgu ndoshta edhe libra apo mjete?

Agim Sylejmani: Po, po, libra, mjete, gjithçka vazhdimisht. Unë thashë, nanën time e ngarkojsha çanta i mushte material.

Anita Susuri: A ka qenë rrezik kjo, për shembull?

Agim Sylejmani: Po, rrezik sa të dush. Rrezik a? Po ni libër me ta...

Anita Susuri: E qysh i keni mshefë për shembull?

Agim Sylejmani: Për shembull, kto të voglat që i pat' që ju tregova merrshim napolitankat, çokollatat e mdhaja ka ni killëshe i heqshim të gjitha edhe ia bojshim të njejtën peshë që e kishte. E mbushnim me gazeta, me libra, me gjithçka, me të njejtën peshë me të ktyne ëmbëlsirave të ndryshme. Edhe përsëri tani me i bo qysh kanë qenë me plasmosje.

Anita Susuri: Cellofon.

Agim Sylejmani: Cellofon po.

Anita Susuri: E kto librat e vogla i keni bo jashtë?

Agim Sylejmani: Jashtë janë bo kto për m'i sjellë pastaj ktu. Se ktu ka qenë mundësia ma e vogël për m'i kriju ktu. Mirëpo, kanë ardhë të gatshme pastaj.

Anita Susuri: Domethonë i keni pasë krejt atë rrjetin e formum, të organizum kush ka me i pritë?

Agim Sylejmani: Po, po, po, po.

Anita Susuri: Qysh jeni marrë vesh? Me telefona?

Agim Sylejmani: Jo, telefona jo. Na i kena pasë paraprakisht. Çdo gja kanë qenë me shkrim. Me shkrim shifër, që edhe me bo me u zanë mos me i ra bash shpejt në fije ata. Unë thashë, kom përdorë, kom shfrytëzu raportet e mia me nanën. Nana m'ka përkrah shumë. Ajo e ngrata udhëtojke kaniherë me autobus veç ma lehtë, ma pak kontrollë ka pasë në autobus, me autobus. Edhe pse e moshume, vike, ose i kom dërgu edhe në Shkup për me evitu këtë aeroportin e Prishtinës. Po edhe shoktë, edhe puntortë, shembull dy çanta të tilla me materiale të tilla niherë...

Se të gjithë keni dëgju për Lutfi Hazirin këtë kryetarin e Gjilanit, ky e ka pasë ni babë të mrekullueshëm. Ai kurrë nuk ka ardhë në Kosovë pa lajmëru që po shkoj në Kosovë, "Çka t'kini m'i jepni me vete". Atina, unë me durë të mija ia kom mbushë dy çanta plot. Domethonë, ka pasë punëtorë që i kanë sjellë. Unë i përmenda edhe dajtë e mi. Ata kanë sjellë libra me thasë. Domethonë, ata kanë vazhdu, kta punëtortë që kanë qenë jashtë, kta vazhdimisht na kanë përkrahë. Se pa mbështetje të tillë edhe pa përkrahje, na s'kishim mujtë me bo asgja. Na faktikisht, na i kemi bo disa punë, po kemi qenë të varun, kushtimisht, me të gjitha prej punëtorëve të tjerë.

Anita Susuri: Domethonë, ju gjatë viteve të '90 keni qenë jashtë...

Agim Sylejmani: Po.

Anita Susuri: Gjatë gjithë kohës domethonë...

Agim Sylejmani: Po.

Anita Susuri: Edhe luftën e keni tejkalu, keni qenë jashtë apo jeni kthy?

Agim Sylejmani: Ju thashë, ju thashë, unë kam qenë në luftë.

Anita Susuri: Ah, okej. Flasim për atë ma tutje veç po du diçka për të '90-tat, veç deshta me ditë kështu...

Agim Sylejmani: Po, po.

Anita Susuri: Vitet e '90-ta osht' formu edhe Ushtria Çlirimtare...

Agim Sylejmani: Po.

Anita Susuri: Edhe a keni ditë ju? A keni... a ka ardhë lajmi deri te ju? Qysh ka ardhë lajmi?

Agim Sylejmani: Jo, kom qenë edhe unë kom qenë i kyçun prej fillimit. Domethonë, kom qenë në ato rrjedha prej fillimit, në ato mundësitë tona na e kena ndihmu. Me formimin e fondit, "Vendlindja thërret", në Lucern është kriju Këshilli i parë në të gjithë diasporën në Lucern është kriju. Kom qenë pjesë e këtij Këshillit. Nga fillimi kom punu, kom mbledhë mjete financiare edhe prej punëtorëve e kom qenë si logjistikë, e kemi qujtë. Logjistikë të UÇK-së.

Në vitin '98 pata arritë Radio Lora quhet në Cyrih, ni radio alternative, nëpërmjet ni mikut tonë shumë të mirë zvicerian Ulrich Urs. Urs Ulrich në fakt mbiemrin, mos ta, tash osht' i ndjerë ka vdekë. Ai na ka pasë mundësu, "Info Internacional" quhej emisioni niherë në javë të premtëve një orë ka qenë aty. Kishe mundësi tani me komunikata, situatën, qato çka i dëgjojmë gjatë javësh shkonim edhe i lëxonim aty në radio për me informu opinionin, qaq sa mund të informohej prej asaj radioje. Edhe pse ka pasë shtrirje bukur të gjerë ajo radio. Se të ritë e përcillnin shumë këtë radion alternative.

Kam qenë i kyçur në logjistikën e UÇK-së. Kemi mbledhë edhe mjete po edhe armatim kemi mbledhë. Kemi marrë, veshmbathje kemi ble për ushtarë, kemi dërgu në Shqipëri. Bile armatimi i parë është me kamiona të Lucernit. Osht' Qamil Isufi ka pasë ai ni firmë të vetën të shpëdicionit edhe i ka dhanë, i ka vu në dispozicion të luftës për me bo bartjen e armatimit kamionat e tij.

Anita Susuri: Gjatë historisë në Kosovë, ka qenë vazhdimisht nifarë lufte e jona për me i thanë, me e pasë ni shtet tonin. Po me thanë, si ma saktësisht, ajo lufta ka fillu, s'po du me thanë ka fillu se ka fillu shumë shumë ma herët po ka ndodhë vrasja e familjes Jashari në vitin...

Agim Sylejmani: '98.

Anita Susuri: '98 në mars edhe qysh u pritë kjo prej juve? Qysh reagutë ju? Çka ndodhi pastaj?

Agim Sylejmani: Shiqo...

Anita Susuri: Për shembull, në Qirez atje...

Agim Sylejmani: Po, po.

Anita Susuri: Ndodhën edhe atje masakrat.

Agim Sylejmani: Ndëgjom. Unë thashë, kom qenë në rrjedha të vazhdueshme nëpërmjet qitij rrethit të shokve që isha i kyçun në qit' logjistikë, kështu që isha në kontakt me çdo informacion të mundshëm që vinte nga Kosova, por kisha edhe shokë ktu me të cilët maja kontakte të rregullta. UÇK-ja bazat e veta apo t'i thushë hapat e parë të krijimit të UÇK-së është '83-ta, kur osht' kriju edhe logjistika e parë e armatimit. Mezija Shemsiu që ka dërgu prej jashtë armatim që ka sjellë ktu në Kosovë. Rexhep Malaj ka qenë komandant i njësiteve guerile, zëvendës komandant, se komandant ushtarak e kanë caktu Adem Demaçin, domethonë si personalitet atë mund ta kem komandant. Domethonë, derisa të bohet ai për me ardhë, punën e kryen Rexhepi. Edhe si i tillë edhe osht' vvarë, si komandant i njësiteve të para guerile. Osht' projekt i '83-tës UÇK-ja.

Tjetër, si emër që ka marrë osht' diçka tjetër në atë kohë është qujtë, Partia e Luftës. Ndoshta ju keni hasë në materiale, quhet Parti e Luftës. Kanë pasë edhe frontin e luftës, domethonë masave, frontin e gjerë të masave po kanë pasë edhe pararojën edhe ushtarake Partia e Luftës. Ktu ka fillu. Me ramjen e ktyne shokve në Prishtinë edhe burgosjen e tjerve osht' zhagitë pak, ka stagnu zhvillimi i matutjeshëm. Shaban Shala i Drenicës, Ali Ahmeti i Kërçovës, kta kanë qenë pjesë e ktyne ngjarjeve. Fehmi Lladrovci e disa të tjerë edhe ky projekt pastaj ka vazhdu. Natyrisht, jo në ato përmasa që kanë ideu në '83-tën.

Emri pastaj, emri si emër është i '84-tes mos të gaboj vitet. Po kam qenë në rrjedha të vazhdueshme. Thashë, edhe kemi shkru për kto edhe kemi majtë tubime, edhe kemi majtë protesta edhe demonstrata UÇK-në e kemi pasë vazhdimisht. Unë kom qenë gjithmonë pjesë e UÇK-së pastaj. Unë kam qenë jashtë, kom vepru si pjesëtar i lëvizjes LPRK që i kanë thanë, po ajo ka qenë në dy pjesë, që të mos bojmë ngatërresa, ka qenë lëvizja me adresë edhe pa adresë. Nuk di sa jeni të informum se nuk po flitet shumë, por ajo ka qenë e ndame, në '86-ën janë nda. Se u kriju në '82-tën, por u nda njëni, pastaj u nda tjetri, pastaj u nda përsëri ni grup.

Kanë ekzistuar dy lëvizje me të njejtin emër në të njejtën gazetë e kanë nxjerrë. Unë kam qenë këtë me adresë, kushtimisht, që me bo dallimet ku kam qenë. Po ndërsa me UÇK-në edhe krahun e luftës kanë qenë kta që kanë qenë të kyçun kta pa adresë. Se kam qenë shokë me ta, kam qenë ma i afërt që nga '94-ta edhe kur u formu fondi, "Vendlindja thretet" Thashë, kam qenë nga fillimit aty, ka qenë Xheladin Gashi, "Plaku" që i kena thanë ne. Ai ka pasë ardhë prej Kosovës, ai ka qenë iniciatori i krijimit të fondit edhe kam qenë aty, aty kam vepru.

'98-ta pastaj ka qenë e randë për neve shumë. Për çdokënd veç për ne jashtë ka qenë pak ma e randë. Se po vriten 53 vetë me ni vend. Ni luftë tre ditore me ushtri, me fmi, me gra, nëpër... ka qenë e randë. Edhe pse pas rrethimit që i bohet në janar '98-ës gjithë kanë thanë që pse s'e largon familjen, po nuk

ka mujtë m'i largu ai se s'ka dashtë me u largu ata familja. Ju ka thanë, "Po s'po dojnë, me zor s'po muj me i nxjerrë prej shpisë", se ai nuk ka pasë qef me fmi të vet nëpër kamë, me fmi të vegjël e me gra.

Mirëpo, ka qenë ni motivues i paimagjinueshëm për neve jashtë. Aty ka fillu tani masovizimi i UÇK-së se kanë qenë grupe të vogla të gueriles në atë kohë. Janë mbledhë, ndoshta kanë qenë gjithë Kosovën 400 vetë, hipotetikusht po flas. Se grupe krejt të vogla po po them me logjistikë me të gjitha 400. Mirëpo, ka marrë ajo ni hov të paimagjinueshëm jashtë. Njerëzit kanë lanë gra e fmi atje jashtë edhe ka lanë punë me çdo gja edhe ka ardhë këtej. Ky ka qenë ai motivi i madh që neve na ka fut në lëvizje të gjithë.

Anita Susuri: A jeni kthy edhe ju qat' kohë?

Agim Sylejmani: Unë jom kthy... unë kom vazhdu logjistikë se u dashtë me nejtë dikush atje deri '99-tën.

Pjesa e Pestë

Agim Sylejmani: Fillimisht kom kry stërvitjet në Helshan pastaj kur u hap fronti Bislim Zyrabin e kanë dërgu me ofciera atje në Shqipëri. E Bislimi pastaj na ka pasë marrë disave në operativë. Kom qenë tani në operativë si administrator në operativën e komandës së shtabit operacionit "Shigjeta".

Anita Susuri: Në cilin vit?

Agim Sylejmani: Në prill '99-tës. Kom qenë me shërbim deri më 13 gusht '99-tes. 13 gusht kom kërkua tani demobilizim se unë s'kam qenë ushtarak edhe nuk kisha ambicie të jem, të ngelem ushtarak. Në pushtet s'kam dashtë gjithashtu, se s'kom qenë as në burg as në luftë për pushtet. Kështu që, nuk kam dashtë me shku nëpër banesa edhe shpija të shkive qysh u futshin disa. Unë timen s'e kisha, domethonë ma s'pari po e ndërtoj pastaj po kthehem.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qato mujt, domethonë marsi ka qenë...

Agim Sylejmani: Aty kur kam shku në Helshan me ni periudhë kur tri javë nuk na u ka ndalë shiu kurrë. Shi me borë, skllotë apo si quhet. Edhe kushtet mizerje kanë qenë. Bukë niherë në ditë kanë hangër, s'ka pasë edhe ata u dashke me lypë me gjetë naj kokërr fasuli se kemi qenë keq. Për armatim kemi qenë hala ma keq. 1300, 1600 ushtarë kanë qenë aty në Helshan në qat' kohë edhe nuk kanë qenë as dy gryka zjarri. S'kemi pasë armë. Kanë qenë, lufta ka qenë e sabotume nga të gjitha anët.

Kta të hujtë, se na kem qef, na kanë shliku të hujtë e amerikantë e bojmë hyxhym po s'na kanë lanë asni fishek, na i kanë pre të gjitha vijat e furnizimit. Pse nuk na jipnin neve sikur në Ukrainë? S'ka pasë

nevojë me luftu kërkush për neve, veç me na dhanë armatimin. Ne s'kemi pasë armatim të mjaftueshëm derisa Kudusi Lame na ka dhanë nga magazinat e ushtrisë shqiptare.

Anita Susuri: Qysh ka ndodhë, bash dashta me vetë, qiky furnizimi...

Agim Sylejmani: Furnizimi, ne kena ble, na armatim nëpër krejt Shqipërinë kena marrë në disa vende na kanë dhanë edhe falë, por kryesisht osht' blerë. E keqja osht' që Ilir Konushevc, Mërgimi osht' vra në pritë nga vet shkak. Unë them, tash ky është mendim i imi personal, nga vet shkak se ai njëqind lekë të Shqipnisë nuk ka ditë me shndërru në njëqind dollarë. Qaq sa e ka marrë dhetë lekë, dhetë lekë e ka shënu. Dikujt ndoshta i ka interesu që qajo njëqind leku me figuru njëqind dollarë, po them kushtimisht. Kështu që edhe osht' vrarë, mendoj unë. Ky është mendim i imi personal. Se përmenihërë osht' shtrajtu armatimi në Shqipëri. Domethonë, mu m'len me dyshu këtë pistë.

Armatim nuk kemi pasë të mirë. Kemi pasë armatim të kazermave fillimisht, deri kah fundi i prillit. Nga fundi i prillit pastaj kemi marrë armatim me kamiona edhe me traktora prej ushtrisë shqiptare. Krejt i kena pasë të ushtrisë shqiptare armatimin. Armatim të mirë, armatim të luftës që ka qenë i përgatitun ma herët për luftën e Kosovës. "Armatim për Kosovë", "Municion për Kosovë", ato arkat e mdhaja kanë shënu.

Anita Susuri: A ka qenë, sigurisht ka qenë rrezik m'i transportu ato?

Agim Sylejmani: Ata janë heronjtë për të cilët flitet ma së paku. Ata janë heronjë shumë të mdhej. Me bartë armatim në shpindë, me furnizu, me kuaj e me gomarë osht' e paimagjinueshme për ne ktu ku po rrijmë tash. Ndërsa unë e di, e kam ni inxhizim të ni Agron Bajrami, ka qenë valltar, nuk di a keni dëgju për të. Ka vdekë ai tash, nuk është gjallë. Po ai në '98-ën e ka lanë grunë edhe fminë edhe ka ardhë me kamerë se ka pasë edhe kamerë të vetën edhe ka bo inxhizim. Veç ta shofish atë kolonën e ushtarëve të armatosur që futen në Kosovë dhe në çfarë kushte dhe çfarë... tash municioni osht' shumë i randë, armën e qet' me ni rryp në shpinë po municioni ai osht' i randë.

Peshë e randë është 30-40 kile me i ngarku edhe me u ngjitë në atë kohë. Është e tmerrshme, nuk e imagjionon dot pa e provu vet nuk e imagjionin. Po tani aq shumë janë vra në kufi, nuk i përmend kërkush. Kjo është e keqja. Na jena furnizu me kuaj, me gomarë në shpinë. Bile ma shumë në shpinë sesa me kuaj. Ndërsa kur osht' hapë fronti i madh në Shqipëri e kemi pasë logjistikën me kamiona. Armatim e municion kurrë mos ia nal gishtin. Po na dhanë falë qitij Kudusi Lamës, gjeneralit të Kukësit. Pak e përmendin, a në fakt, ky ka merita të jashtëzakonshme.

Anita Susuri: Osht' kjo, data mars kur fillon bombardimi edhe qysh janë konë qato ditë edhe deri në shlibrim për juve?

Agim Sylejmani: Vet sulmi nuk ka ndodhë krejt rastësisht. Me m'pytë mu, unë mendimin tim e jap, kjo ka qenë me marrëveshje. Në të njejtën kohë ka qenë edhe problemi i Çeçenisë. Në Çeçeni të shtrënguar nga lufta e çeçenëve ata u detyrun me e bo ni armëpushim edhe ni status quo për tri vjet. U tërhoqën rustë prej Çeçenisë. Erdh puna tash p'e sulmojmë Jugosllavinë, Serbinë për shkak të Kosovës, mirë. Pse nuk e sulmunë Serbinë kur boni masakra në Bosnje? Kërkush nuk pyet. Bile shkun edhe kta ushtartë e hujë edhe në prezencë të tyre i vrisnin. Bile edhe në bashkëpunim me ta i vranin në Srebrenicë tetë mijë burra. Helmetë-kaltërtit kanë qenë aty të Holandës.

Anita Susuri: Po.

Agim Sylejmani: Edhe status quo e tri vjetve në Çeçeni nuk zgjati ma shumë se ni vit e gjysë edhe kërkush nuk ka reagu në Europë pse u fute në Çeçeni? Pse more Çeçeninë? Ishte me marrëveshje. Kur po them me marrëveshje e kthej shiritin mrapa. Pse në Irak i mshojshin në Baghdad drejtpërdrejtë edhe derisa e zunë Saddam Hussein. Ndërsa këtu shkojshin bombardojshin nëpër fusha, male gjujshin, naj pompë benzine. Ka qenë ni marrëveshje si duket e tyre që ushtria jugosllave s'guxon m'u damtu. Vet fakti që ni hupës, kur e kthen me mendu, ai që hup luftën ai shkon me durë në xhepa te shpija. Ushtria e Serbisë edhe fishekun e fundit e ka marrë prej Kosovës, si ka mundësi kjo?

Amerikantë e humbën luftën në Vietnam, për mos me lanë [asgjë] në Vietnam e hidhshin në deti, se u dashke veç me tesha të trupit me shku në Amerikë. E humbën luftën në Afghanistan, kanë ikë përpara që mos me lanë armatimin aty. S'mun merr me vete ti. Edhe ju ngeli 300 mijë, për 300 mijë ushtarë ju ngeli armatim në Afghanistan. Si u boka kjo e Serbisë komplet m'u tërheqë pa asni therrë n'kamë? Kërkush nuk e mendon, nuk e analizon këtë. Në anën tjetër, pse nuk ia futën ni tanku bile me shkatërru NATO-ja? Ka shkatërru shembull kjo si është qajtë? "Marshall Tito"? Si është qajtë kjo kazerma ktu në Prishtinë? Tash që është, "Adem Jashari", përpara ka qenë kazermë aty. Edhe në Gjilan qashtu, qasi soji.

Mirëpo, para se me u bombardu ato, kta kanë qenë të lajmërum që këtë ditë do të godasim. I kanë hjekë të gjitha. Asni armë e tyre nuk është shkatërru, vetëm barakat po për me bo bujë që kena bo diçka. Pse bombardojshin këtu? Unë këtë nuk e kuptoj. Çka ka pasë ktu me bombardu? Bjeri në kokë gjarpërit. Po edhe me bo marrëveshje me Milloshin edhe mos me bombardu Beogradin kjo diçka... Kështu që, unë kam qenë pjesë e operativës që thashë edhe i shisha gjërat çka bohen. Veç ni shembull të vogël për me përmyllë kta, për me pasë... na i jipshim koordinatat e sakta. Prej asaj operativës tonë kanë shku koordinatat për bombardim, i dërgojshin aty te ajo që kanë pasë ni zyre të veçantë e patë ngritë kta me pajisje në Kukës.

Me melimetër po them, për m'i ikë ksaj fjalës, milimetër me centimetra kanë qenë koordinatat e sistemit kanë qenë koordinatat e sistemit raketor te Liqeni i Radoniqit. Kurrë s'kanë lëvizë prej atyhit. Pse nuk i kanë shkatërru NATO-ja ato, sistemin raketor? As ushtarë s'kanë vra. Përse u bo... për mu ka qenë e dyshimtë, ka qenë kjo loja që e qujë unë, kanë përdorë këtë hapësirë për sofistifikimin edhe

përpunimin e armëve të tyre high-tech teknologji që i thojnë kta të armatimit. Pastaj, kur qenka qashtu pse more nuk na dhanë neve, pse nuk na jepshin neve armtë kur po dojnë me na nimu. Veç me na i dhanë armtë, s'ka pasë nevojë me ardhë as aeroplana, as me luftu dikush prej tyre na ishim mjaft ushtarë.

Në Shqipëri janë kanë gati mbi dymdhjetë mijë ushtarë kemi qenë. Mirëpo, nuk na kanë dhanë armatim, as municion. Kështu që, për mu është shumë diskutabile. Kur e shoh rezultatin, ktu nuk u bo lufta e NATO-s 72 ditë, po ktu kanë bo teatër. Na i shishim, i përcjellshim me dylbi nganjëherë, shkante aeroplani kшту {tregon me duar në shenjë rrethi}, sillej, sillej disa xhiro i bojke e u kthejke në Malin Gjallica e kanë pasë ni vend e zbrashin municionin aty ose në deti atje në Adriatik para se me u lëshu në Aviano. Domethonë, kto për mu janë dyshim. Pse nuk e zbraste ktu? Ka pasë mjaft ku. Jo, ktu në Kosovë, në Serbi atje.

Domethonë, kur i boj këto krahasime me këto vendet e tjera këtu te ne po po m'dukët disi sikur kanë luftë me neve shumë për interesa të veta. Të përfundoj ni luftë që sa ma pak teren, sa ma pak ndikim, sa ma pak ushtarë të UÇK-së, pikë. Edhe tamam qashtu doli. Niherë kur osht' majtë ni ofenzivë me 26 maj [1999] kanë hy disa kilometra mrena territorit. Ku kanë qenë pikërisht këta të NATO-s që kanë bo presion edhe u dashtë me u tërhjekë ushtria deri në 500 metra, kërkush nuk e bisedon këtë. Prandaj është kjo e NATO-s për mu ka qenë ni lojë. Se p'i shoh, ja tash, shihni tash, shifni sa armatimin e dërgojnë. Një miliardë e gjysmë brenda dy-tri ditëve kanë dhanë armatim. Për neve nuk ka pasë nevojë qaq, dhetë milion kanë qenë të mjaftueshme.

Anita Susuri: Po. Deshta me pytë për familjen e juj, sigurisht kanë qenë jashtë bashkëshortja...

Agim Sylejmani: Veç gruja edhe djali, kta tjetër kanë qenë krejt këtu. Nuk kanë dalë prej ktuhit asnjëni. Kanë qenë këtu gjatë tërë kohës.

Anita Susuri: Kanë qenë në Prishtinë apo?

Agim Sylejmani: Në Prishtinë, në Prishtinë kanë qenë.

Anita Susuri: S'e kanë...

Agim Sylejmani: Jo nuk kanë...

Anita Susuri: Edhe në kohën kur i kanë qitë prej banesave kta kanë qenë këtu?

Agim Sylejmani: Po, baju prej ni banese, kanë shku kështu vetëm ktu kanë ndejtë nuk kanë dalë prej ktuhit. Kanë vendosë, "Edhe të na vrajshin, le të na vrajnë. Nuk po dalim prej ktuhit".

Anita Susuri: A keni pasë ndonjë kontakt me këta?

Agim Sylejmani: Me ta kontaktin kur e kom vendosë, kom vendosë vetëm me motrën. Motra ka qenë në Strugë. Në Strugë e martume motra që nifarë mënyre veç me pasë... ajo ka pasë kontakt me ta, me pasë unë, me ditë a janë gjallë. Hala s'e e disha sikur tjetrtë edhe të mitë mujnë m'i vra, nuk osht' diçka e jashtëzakonshme për ato kohë. Babën e kom thirrë pastaj në telefon me... ka qenë 13 ose 14 qershori [1999]. Ai baba nuk e ka ditë që jom, kta tjetrtë e kanë ditë, veç baba nuk e ka ditë se mos me i kriju shqetësim ma tepër atij.

Anita Susuri: Nuk e ka ditë që jeni në luftë?

Agim Sylejmani: Ai nuk e ka ditë që jom në luftë, jo. Ni emision që, se na ka përcjellë ni televizion i Zvicrrës kur kemi shku për në Shqipëri atje. M'kanë përcjellë mu deri me ni vend tani i kom thanë, "Prej këtu kthehuni mrapa". Mirëpo, për fat baba s'e ka pa, tjetrtë e kanë pa, po vetëm baba nuk e ka pa atë dokumentarin. Kështu që, ai nuk ka ditë kurgjo. I ka ardhë pak, e ka pasë pak si befasi.

Anita Susuri: Qysh, a ka qenë tani i lumtur që keni qenë pjesë?

Agim Sylejmani: Jo, tani me gjyks, me rreh gjyks qysh jo (qeshë). Po edhe vllau ka ndihmu këtu. Ka qenë i kyçun ky me ndihma, me ilaçe, sidomos në zonën e Llapit e ka ndihmu. Ai ka qenë i lidhur me ata të Llapit kështu.

Anita Susuri: E qysh e keni marrë lajmin që ka përfundu lufta?

Agim Sylejmani: E na, unë thashë, unë kom qenë në operativë...

Anita Susuri: Po.

Agim Sylejmani: Në operativën operacionit "Shigjeta", domethonë lajmet ma së pari na vishin aty. S'ka pasë kujt, kërkush tjetër s'ka mujtë para neve me i marrë vesh. Bile ka qenë ni, i kemi edhe fotografitë e rastit, i kena bo shpejt e shpejt, i kena improvizu nifarë vendi. Kërkush nuk e ka pritë që po përfundon lufta, na thoshim tek tash ka fillu se tek qatëherë u furnizum me armatim të mirëfilltë. Me të 9-tin [qershor] e kemi marrë vesh, meniherë. Tamon u nënshkru atje, t'i thushë gjysë ore ma vonë nuk ka qenë ma shumë. Edhe aty për aty nja disa tavolina që kanë qenë pak kemi pasë shtru me do ngjyrë të kaltërt do letër. Se ku i gjeti dikush i bonëm nifarë lloj dekori me ngritë nga një gotë kështu (qeshë). I kemi disa fotografi bash të qatij momentit.

Anita Susuri: E me familjen, a jeni bashku shumë shpejt pas asaj apo?

Agim Sylejmani: Jo, unë kom vazhdu pastaj këtu nëpër teren se ka pasë punë hala. Tani kom shku për nja ni javë e kom marrë pushim prej përgjegjësit, komandantit, leje, domethonë më kanë dhanë leje me udhëtu. Kom shku e kom marrë familjen, te dy i kom marrë prej atjehit edhe pse ka qenë akoma rrezik, se shumë grupe të Arkanit³ e grupe paramilitare kanë pasë mbetë në teren kësajde. Kështu që, rrezik ka qenë por megjithatë unë i kom pru në qat' kohë. Të dy kanë ardhë edhe ata.

Anita Susuri: Qysh ka vazhdu jeta mas luftës? Qysh jeni rikuperu?

Agim Sylejmani: Mas luftës, unë thashë, jom zhgënjy shumë shpejt në atë drejtim se pse u bo lufta për me vrapu pas pasurisë apo pas sendeve. Kështu që, me 13 gusht unë kom kërkë me u demobilizu, nuk kom dashtë me ndejtë ma aktiv. Aktivitetin e kom vazhdu atje në Zvicërr, nuk jom ndalë, por ktu kom mendu që nuk kthena ma prej Kosovës atje. Mirëpo, ktu kur fillunë ato edhe mënyra të tilla edhe çdo gja e morën në dorë të hujtë, na s'kishim kurgjo në dorë, si shqiptarë kurgjo. Ata që ishin, ishin si kuklla kurgjo tjetër, gja në dynja s'kanë bo, asgjë. Ishim ra në dorë të një UNMIK-u⁴, një shërbimi që faktikisht nuk punojke asgjë për neve.

Na kishin vnu ni kërrpesh me ni 1244, rezolutë që nuk ishte qëllimi edhe i luftës për ni gja të tillë. Se shtrohet pytja, po pse u vranë gjithë aq shumë njerëz? Për me mbetë akoma në letër që territor i Serbisë. Se lufta nuk bohet për ideologji as fe, lufta bohet për territore, për luftë. Serbia bon luftë edhe pse s'ka njerëz. Krejt Kopaoniku osht' i shprazët, s'ka njerëz, mirëpo ajo don territor. Sidomos ku ka territor mundësisht çka të kenë pasuri nëntokësore i duan.

Anita Susuri: Ju keni fillu edhe kujtimet e juja edhe me i regjistru për shembull me i arkivu me libra, keni publiku libra...

Agim Sylejmani: Unë me kujtime akoma s'kam fillu. Unë fillimisht kom mbledhë shkrimet e mija i kam dy vëllime janë nja 600 faqe, po nuk i kom botu akoma. Ato 600 faqe kur të palohet si libër dalin 1200...

Anita Susuri: Ato si autobiografi?

Agim Sylejmani: Jo, ato janë shkrime të mija, shkrime ndër kohë. Ka që janë botu edhe që s'janë botu fare, i kom mbledhë i kom selektu. Mirëpo, nuk e kom botu pa mbaru disa me shoktë të cilët... duhet me ndje secili ni borxh ndaj shokut që s'osht ma. Unë që po marrë frymë akoma, po pi lang, po ha bukë, ai tjetri s'osht' fare. Rexhep Malaj, kom pasë njoftë fatmirësisht edhe para burgut, por kom pasë

³ Zhelko Razhnatović (1952 - 2000), i njohur si Arkan, ishte komandant i një force paramilitare serbe gjatë luftërave në Jugosllavi. Ai ishte në listën e më të kërkuarve të Interpolit në vitet 1970 dhe 1980 për grabitje dhe vrasje të kryera në disa vende anembanë Evropës, dhe më vonë u padit nga Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë për krime kundër njerëzimit. Grupet e tij paramilitare kishin kryer edhe krime në Kosovë. Razhnatović ishte vrarë në Serbi në vitin 2000.

⁴ UNMIK - *United Nations Mission in Kosovo*. Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë është misioni zyrtar i mandatuar i Kombeve të Bashkuara në Kosovë nga viti 1999 deri 2008.

fatim ma të madh që jom taku me to edhe kom bo burg me to. Kom ndje ni borxh shumë të madh ndaj tij edhe fillimisht kom fillu monografi po e kom bo roman në ndërkohë. Se çdo gjë e tij osht' zhdukë edhe në Arkivën e Kosovës siç ka qenë kutija edhe shkrun aty, "Rexhep Malaj", mirëpo brenda osht' e shprazët, asni letër s'osht'. Dikush i ka marrë. I ka marrë pas luftës, jo para luftës, pas luftës i ka marrë dikush m'i zhdukë.

E kom shndërru në roman po për të vazhduar për monografinë. Meniherë pas romanit që e kom promovu në qershor, 21 qershor 2013-ën kisha dëshirë me një përvjetor kur ka dalë nga burgu ai. Edhe libri ka dalë me 23 maj prej shtypit, qat' ditë kur ka dalë ai nga burgu '83-tën. Po për 30 vjetorin pastaj e kom bo mas gjashtë mujve se arrita m'i siguru do dokumenta anash me nxjerrë monografinë. Kto te dyja janë për Rexhepin. Ia kom kushtu atij domethonë edhe si roman për [me qenë] ma e kapshme për këtë brezin kom dashtë ta bëj ma të kapshëm, çka ka ndodhë në ato ditë në formë letrare, por monografia pastaj me faktografi dokumentare.

Kisha ni shok këtu në Bujan me të cilin kom vazhdu në atë kohën pas burgu, që thashë mas burgut që jam lidhë me ta edhe kom vepru, ai vdiq në 2007-ën nga kanceri. E ndjejsa një përgjegjësi ndaj një shoku që ka vdekë e aq shumë bukë kom hongër aty e kemi shku gjithandej bashkë, kemi aksione. Kështu që, nuk dojsha edhe me shku me shpreh ngushëllime pa fillu ni libër për të. Edhe, nëse e kom marrë ktu, apo jo, s'e pasna marrë si duket atë librën, e kom monografinë për të. Po, këtu e pasna. Edhe ia kom kushtu ni monografi për jetën dhe veprimtarinë e tij.

Kështu që, pastaj e kom bo ni monografi për Sadikun. Ky ka qenë në '81-shin në burg pastaj është burgosë edhe në '86-ën pastaj. Në 2007-ën vdiq. As në ish Jugosllavi, ta qujë kështu, në ish pushtetin e as pas luftës, kurrë në punë nuk e kanë fut. Ni kallaballëk fmi, ni lopë e ka pasë sa për qumësht, e ka rujtë ni lopë për m'i dhonë qumësht fmise. Kështu që, e kom ndje ni barrë të madhe ndaj tij.

Anita Susuri: A ka qenë i organizum në OMLK?

Agim Sylejmani: Po, i organizum në OMLK ka qenë. I organizum me mu ka qenë dhe drejtues i komitetit lokal për Lipjan-Ferizaj. Kështu që, e kom ndje aty ni barrë shumë të randë të përgjegjësisë që të boj diçka për të. E kom bo pastaj këtë libër. Baba kishte ditëlindjen e 80-të edhe mendojshim çka m'i bo për ditëlindje, po pleqve orgainzoja ni ditë, boj çka të dush, blej çka të dush, [ata] qat' ditë gzohen por të nesërmen harrojnë. Edhe më lindi ideja që të bëj diçka të veçantë edhe kom mbledhë tinëz tij materiale për t'ia bërë ni libër biografik {e tregon librin}. Në fakt, ky libër në esencë përveç jetës së tij është jeta e gjithë asaj plejade të mësusve të asaj kohe.

Unë ju thashë parëz, ky me 16 vjet ka fillu mësus. Tash mund ta imagjinosh ni 16 vjeçar të shkoj edhe të punoj me ni mal atje në Muqibabë ku ka punu. Po ka punu pastaj edhe me shkencë, është marrë me shkencë të matematikës, prandaj janë këto vizatime kështu se është marrë me shkencën e matematikës. Edhe ia kom punu këtë libër automatik. Ku ni pjesë faktikisht është edhe jeta ime aty se

aty udhëtoj tani edhe unë me të bashkë. Meqë punoj me një studio televizive atje në New York, në televizion shqiptarë është Qazim Dodaj drejtor ekzekutiv, ai ma ka lanë në hapësirë të pakufishme po edhe pa gërrshërë. E kam gjetë vetën pastaj aty që çkado që të boj e di që aty me m'prekë, s'më prekë.

Kom bo shumë intervista edhe dokumentarë për një emision që e quaj, "Rujtja e vlerave të luftës", m'i sjellë para ekranit kta që bonën diçka për këtë vend. Njërin nga ato intervistat e para e kom bo me Mehmet Hajrizin, drejtorin, një nga drejtuesit kryesor të OMLK-së. Mirëpo, është kërku shumë herë nga shikuesit ajo intervistë, e kom pasë transmetu në gjashtë pjesë edhe pastaj e kemi transkriptu edhe e kemi bo si libër {tregon librin}. U dalë në libër i mirë kështu. Se ky i ka dy libra, një e ka, "Historia e një organizate politike", edhe, "Demonstratat e vitit '81". Edhe pastaj të dytën, "Nga grupi revolucionar deri tek tezat e frontit për Republikën e Kosovës". Mirëpo, ajo është dokumentar, është e thatë për me kuptu gjithkush. Ndërsa kjo është sikur e plotëson. Nëpërmjet intervistës plotësohen ato dyjat. E kom bo si libër pastaj se u paraqit kërkesa edhe nevoja me bo, deskriptu librin.

Pastaj i kom hy asaj që thashë, punën e rrëfimeve nga burgu, që tv burgosurit nuk flasin për veti. Edhe fillova në si projekt, "Rrëfime nga burgu" {tregon librin}. Domethonë, secili me nga një rrëfim dhjetë, 15 faqe deri 20 faqe të librit me pasë në rrëfim, në të burgosuri. Ktu janë një 30, libri i parë. Osh' pritë mirë edhe pastaj kam vazhdu me monografi të tjera. Ka qenë monografia për një figurë tjetër të rrethit të trevave të Gjilanit, Nazmi Hoxha, [tregon librin]. Osh' një prej veprimtarëve tjerë të OMLK-së i cili edhe ky ka vdekur pas luftës. Po ka kontribu edhe gjatë kohës të luftës, sidomos në Shqipëri për logjistikën e UÇK-së.

Pasi kam mbaru me të, më ka... kom hasë në dokumentat e... shkresat e punëtorëve të Sigurimit, inspektorëve që kanë qenë të ngarkum me survijimin apo mbikqyrjen e të burgosurve politikë dhe hasa në dokumente që kanë të bëjnë me Rexhepin. Kështu që, me Rexhep Malën {tregon librin} faktikisht ky është libri i tretë që ka të bëjë me të. Por ky libër tash nuk është vetëm për Rexhepin, po është për Rafi Halilin në fakt. Ia kom vu titullin për Rexhepin se e kishte 70 vjetorin e lindjes edhe me rastin e 70 vjetorit të lindjes, vitin e kaluar e kom publiku librin.

Meqë, siç thashë kom mbajtë ditar në '88-'89, ditar të përditshëm dhe m'ka mundu gjithmonë qajo situata e atyre dy viteve. Në anën tjetër nuk flitet, nuk shkruhet shumë për ato ngjarje, ju kom fut pastaj asaj monografisë për një dëshmor të '89-tës {tregon librin}, përmes të cilit rrugëtojmë edhe në ato vite kur ishin këto ngjarje kaq të mëdha dhe nuk flet askush. Ky është njëri prej atyre dhjetra e dhjetra të vlarëve. Ktu pastaj trajtohet pikërisht qajo në mënyrë kronologjike apo telegrafikisht edhe ajo pjesë e ngjarjeve çka ndodhi, kur edhe si. Po duke rrugëtuar bashkë me këtë personazhin e librit. Ktu tash, ky është libri i nëntë, kam dorëshkrim edhe disa tjera.

Jom edhe në projekt që është shumë, ndoshta shumë interesant, "Mësimdhanësit dhe të burgosurit politikë të fshatit Përlepnicë". Osh' në fshat që çuditërisht ka prodhu shumë msusa, mësimdhanës. S'ka shpi që s'i ka kah tre a katër. Nuk din njeriu me ta shpjegu pse, pse kjo dashuri për profesion. Aty

shumë, me shumicë janë shkollu fshati Përlepnice, por mësimdhanës është e çuditshme pse ka dhanë. Kështu që, m'ka ngelë kjo, nashta edhe nga baba që m'ka folë shumë dhe kom dashtë me bo diçka për Përlepticën. Aty jom bashkëautor me një bashkëvendas aty, Nuh Nuh, jemi t'u e përgatitë një monografi për këtë temë. Ju lodha (qeshë).

Anita Susuri: Jo tamon puna, po pres a e keni kry. Nëse doni edhe diçka për fund me shtu, nëse jo e kishim përfund. Nëse keni edhe diçka që ka mbetë...

Agim Sylejmani: Shiqo, na kemi shumë çka flasim. Ndoshta me një bisedë nuk mbarojnë, janë pa mbarim. Po atë që e di që nuk bon me harru të kaluarën se nuk e dijmë nga do të shkojmë edhe nuk mund ta njofish as të sotmen po nuk e dite çka ka ndodhë në të kaluarën. Pavarësisht që qe 22 vite është investu shumë parë ktu, pikërisht në këtë projekt që mundësisht të mos kqyrmi mrapa dhe ta harrojmë çka ka ndodhë ktu edhe veç përpara të shohim. Po qysh me shku përpara kur nuk e shoh kah kom ecë unë. Kështu që, do t'ishte e mirë kjo... po më vjen mirë ky projekti juj tashti se osht' pikërisht në qat' synimet e mija të lojmë diçka brezave çka të vijnë, [rreth asaj] çka ishte deri sot. Deri sot çka kemi jetu se çka ndodhë të nesërmen e dijnë brezat e tjerë, po bile mos t'i lojmë në terrin informativ.

Prandaj përmes jush, mu po më pëlqen ky projekti juj në atë kuptim. Atë ditë kur e bisedum me ata shoktë, mu më pëlqeu jashtëzakonisht se tek e fundit jeni në brez i ri, nuk jeni brez i jonë. Po më vjen mirë që brezi juj po e bon në gja të tillë. Unë thashë, unë kom fillu pikërisht për këtë qëllim edhe "Rrëfime nga burgu", edhe mirrem edhe me leksione kur ishte fjala për leksione të të burgosurve isha prap i kyçun se osht' diçka që ka të bëjë edhe me mu, e ndjej kështu pikërisht që m'i lanë brezit diçka. Le të shohin kush kanë qenë ose çka kanë bo. Le të dihet çfarë rrugëtimi boni kjo gjeneratë, ky brez, se nuk ka ardhë prej qiellit asgjë. Vinin disa bomba prej NATO-s prej qiellit, po nuk na bijshin ku duheshin me ra. Se në Beograd nuk binin, i shponin arat e Kosovës i bonin gropa gropa. Fatkeqësisht.

Anita Susuri: Ju faleminderit shumë edhe për kohën edhe për intervistën.

Agim Sylejmani: Ju faleminderit juve që më durut se kemi aq shumë (qeshë).

Anita Susuri: Ishte kënaqësi.

Agim Sylejmani: Shumë shumë faleminderit prej jush. Ju uroj sukses!